



USHTRIA



Viti i 71-të i botimit Nr. 20 (827564)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 20 Prill 2018

GJENERAL KOLLÇAKU PRITI HOMOLOGUN MAQEDONAS GJENERAL VELICHKOVSKI




FA mbështet integrimin e Maqedonisë në NATO

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FARSH, Gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku priti në Shtabin e Përgjithshëm, ditën e mërkurë, më 18 prill 2018, në një takim të veçantë shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Maqedonisë, gjenerallejtënant Metodija Velichkovski dhe delegacionin që e shoqëronte. Pas pritjes ceremoniale të dy

delegacionet zhvilluan bisedime për çështje me interes reciprok, që përfshijnë çështje në marrëdhëniet bilaterale në kuadrin rajonal dhe atë të Aleancës. Gjeneral brigade Kollçaku, pasi i uroi mirëseardhjen homologut të tij maqedonas, vlerësoi si shumë të rëndësishëm bashkëpunimin ushtarak dypalësh për sigurinë... >>> faqe 5

INTERVISTË PËR "ZËRI I AMERIKËS"

Xhaçka: Shqipëria ka propozuar opsione për baza tokësore



>>> faqe 2

Sekretari Amerikan i Mbrojtjes

James Mattis: Do të keni gjithmonë ndihmën tonë

Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, gjatë vizitës zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës u prit më 18 prill, nga sekretari i Mbrojtjes, James Mattis >>> faqe 3



Gjenerale Shehu - kolonel Duda

Shumë i mirë bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes

Zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjenerale brigade Manushaqe Shehu, priti më 11 prill 2018, në një takim atasheun ushtarak francez, jo rezident në vendin tonë, kolonel Fabrice Duda, me kërkesë të këtij të fundit për marrjen e një feedback-u, për pjesëmarrjen...



>>> faqe 5

B1k dhe Batalioni "Komando"

220 trupa dhe 15 mjete, kanë filluar pastrimin e territorit

Efektivët e Forcës Tokësore, i janë bashkuar në aksionit kombëtar "Të mbajmë pastër tokën që duam". Që në orët e para të mëngjesit të datës 16 prill, rreth 220 trupa dhe 15 mjete, kanë filluar pastrimin e territorit të vendit në pikat më nevralgjike të tij. Operacioni u zhvillua në bashkëpunim të ngushtë me pushtetin vendor të prefekturave Tiranë, Shkodër, Berat... >>> faqe 4

JENS STOLTENBERG NË ANKARA

NATO qëndron në solidaritet me Turqinë

>>> faqe 10

67 VJET AVIACIONI USHTARAK SHQIPTAR

Histori sukcesi e Aviacionit Ushtarak Shqiptar

faqe 6-7

60-VJETORI I KRIJIMIT TË AFA

Thoma Xhixho, personalitet i shquar i arsimit dhe shkencës ushtarake

Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ faqe 14



Intervistë për “Zëri i Amerikës”

Xhaçka: Shqipëria ka propozuar opsione për baza tokësore

Ministrja e Mbrojtjes e Shqipërisë Olta Xhaçka ndodhet në Washington, ku më 18 prill 2018 u takua në Pentagon me Sekretarin amerikan të Mbrojtjes James Mattis. Sekretari Mattis e falenderoi Shqipërinë për angazhimin e saj në NATO si një vend aleat, kontributi i së cilës, siç u shpreh ai, shkon përtej madhësisë së sajshitet. Ai vlerësoi kontributin e Shqipërisë me trupa në misionet e ndryshme të NATO-s, si dhe rolin e Shqipërisë për të mos lejuar, siç u shpreh “ndikimin e dëmshëm rus në rajon”. Në takim Ministrja Xhaçka bëri thirrje për një prani ushtarake të Shteteve të Bashkuara në Shqipëri. Ajo tha se Shqipëria po paraqet disa ide për të vënë në dispozicion baza tokësore, ajrore dhe detare por edhe aftësi të tjera, qoftë në mënyrë dypalëshe me SHBA ose në suazën e NATO-s. Zonja Xhaçka u sugjeroi zyrtarëve amerikanë të mbrojtjes të shikojnë mundësinë që Shqipëria të shërbejë si vend kontakti në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Sipas saj, një prani e SHBA ose e NATO-s mund të ishte një demonstrim i qartë se ky rajon nuk është harruar nga aleatët.

Zëri i Amerikës: Zonja ministre! Cilat janë pritshmëritë tuaja nga kërkesa drejtuar sekretarit Mattis, e cila nuk bëhet për herë të parë?

Olta Xhaçka: Në radhë të parë unë dua të theksoj angazhimin operacional të forcave të armatosura gjatë këtyre viteve si vend aleat i NATO-s. falë këtij angazhimi, falë seriozitetit dhe përparimit që forcat e armatosura kanë realizuar gjatë këtyre viteve, ne jemi për NATO-n dhe për SHBA-të një aleat i denjë, një faktor stabiliteti në rajon dhe një garant i sigurisë së përbashkët e kolektive.

Në këtë kuadër, diksutuam me sekretarin Mattis mbi sfidat e shumëfishta që paraqet sot e gjithë situata e sigurisë, jo vetëm në rajon, por edhe në botë, por diskutuam edhe për Ballkanin perëndimor dhe për specifikat e rajonit tonë. Kërkesa jonë, kërkesa e ministrisë së mbrojtjes në takimin me sekretarin Mattis vjen edhe si rezultat i faktit që NATO sot nuk ka kapacitete të saj në Ballkanin perëndimor. Duke pasur këtë parasysh, duke patur parasysh edhe rolin stabilizues të Shqipërisë në Ballkan, bëmë një kërkesë për të vënë në dispozicion të gjitha kapacitetet tona, qofshin këto baza ushtarake, apo kapacitete ajrore, detare e tokësore si mundësi për të ofruar një garanci për NATO-n dhe për SHBA-të për të përballur sfida që vijnë nga Lindja dhe nga jugu.

Zëri i Amerikës: A keni ju ndonjë sinjal se NATO ka interes që të ketë një bazë të tillë kaq të zgjerura në rajon?

Olta Xhaçka: Me sekretarin Mattis këto ishin disa mundësi për të eksploruar zhvillimin e mëtejshëm të këtyre marrëdhënieve me NATO-n dhe me SHBA-të. Sekretari Mattis u shpreh shumë i predispozuar për t'i konsideruar këto kërkesa. Çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes janë shqetësime të përbashkëta të aleatëve të NATO-s dhe Ballkanit perëndimor është një rajon shumë i rëndësishëm për NATO-n dhe për SHBA-të dhe të gjithë bashkë do të gjejmë zgjidhjet më të mira. Unë mendoj që një prani e NATO-s apo e SHBA-ve në një vend, i cili ka treguar



Intervistë me Ministrën e Mbrojtjes të Shqipërisë, Olta Xhaçka

Zëri i Amerikës
OLTA XHAÇKA
MINISTRE E MBROJTJES SË SHQIPËRISË

gjatë gjithë këtyre viteve me angazhimin dhe kontributin e tij se mund të jetë një aleat shumë i denjë dhe mund të jetë një pikë kontakti apo një gjurmë shumë e mirë për rajonin, do të ishte edhe një mundësi e mirë për të sjellë një standard të ri për forcat e armatosura.

Zëri i Amerikës: Kjo duhet për t'u bërë ballë rreziqeve që vijnë nga Rusia, si thoni ju?

Olta Xhaçka: Pa diskutim, nga Rusia edhe nga jugu, që kanë të bëjnë me influencën ruse, apo që kanë të bëjnë me ekstremizmin fetar, që ne i kemi parë përmes influencës së vet në Ballkanin perëndimor. Nga ana tjetër, një mundësi, një kapacitet i shtuar i NATO-s apo i SHBA-ve në rajon do të sillte një standard tjetër për ata sektorë të ekonomisë, infrastructures

Zëri i Amerikës: Kjo është bërë edhe më herët, zonja ministre, dhe duket se nuk ka ndonjë sinjal, por edhe nga sekretari Mattis nuk është se ka një aprovim të kërkesës që ju bëti.

Olta Xhaçka: Ne nuk po diskutojmë për aprovim, ne po diskutojmë për të eksploruar mundësi të reja, për të thelluar bashkëpunimin me SHBA-të dhe me NATO-n ne funksion të sigurisë dhe të sfidave të përbashkëta. Sfidat që kemi sot janë multidimensionale, janë ndryshe nga ato që kemi patur dje, dhe sot jemi në rrethana të tjera që diktojnë vendime të tjera. Bashkë me aleatët do të gjykojmë se kush është më e mira.

Zëri i Amerikës: Ju folët dje për një rritje të ndikimit rus në Shqipëri. Në bisedën me zotin Mattis përmendët se janë vënë re qëllime dhe interesa edhe nga vende të tjera në rritje, duke përmendur Kinën, Iranin dhe Turqinë. A mund të shpjegoni se çfarë nënkuptoni me këtë?

Olta Xhaçka: Ndoshta këto nuk janë çështje për t'u biseduar dhe eksploruar në një studio televizive, por është e vërtetë ajo që ju thashë pak më parë: influenca ruse në rritje, pra, rreziqet që vijnë nga lindja, por edhe rreziqet që vijnë nga jugu përmes ekstremizmit fetar, apo ërmes aktorëve të tjerë joqeveritarë, të cilët përpiqen të destabilizojnë rajonin në funksion të interesave të tyre. Këto janë çështje të sigurisë, që bashkë me



Intervistë me Ministrën e Mbrojtjes të Shqipërisë, Olta Xhaçka

aleatët ne i konsiderojmë; ka për t'u marrë seriozisht, ka për të mos u marrë seriozisht.

Por kërkesa ime ka të bëjë me faktin që një prani e NATO-s ose e SHBA-ve për Ballkanin perëndimor unë besoj që në këtë moment do të ishte shumë e domosdoshme. Janë rrethanat që diktojnë vendime dhe nëse rrethanat janë të tilla, që kërcënimet dhe sfidat që vijnë nga lindja dhe nga jugu janë të tilla për të na diktuar këtë vendim unë shpresoj që ata do ta konsideronin me seriozitet.

Zëri i Amerikës: Zonja ministre! Ju patët një takim edhe me përfaqësues të kompanisë Lockheed Martin, e cila është një kompani e njohur sa i takon industrisë ushtarake. Gjatë takimit me zotin Mattis ju u shprehët, po ju citoj, që i keni kërkuar kësaj kompanie që të përfshihet me shumë në sistemin e survejimit dtar.

Çfarë nënkuptoni?

Olta Xhaçka: I kam kërkuar kësaj kompanie që të konsiderojë rritjen e kapaciteteve tona dhe ndoshta një investim më të madh në vendin tonë. Bëhet fjalë për gjigandin Lockheed Martin, që është ndoshta kompania më e fuqishme dhe më serioze në gjithë industrinë ushtarake botërore. Lockheed Martin sot është i përfshirë në sitimin e vëzhgimit detar, është ai disajneri i këtij sistemi, si dhe kemi nënshkruar një kontratë për sistemin e integruar ajror, për të cilin Lockheed Martin ka disa muaj që punon.

Zëri i Amerikës: Po menaxhimin e sistemit kush e kryen?

Olta Xhaçka: Menaxhimin e kryen Lockheed Martin dhe partneri i saj italian Gem Electronica, i cili mirëmban sistemin e radarëve detarë, ndërsa Lockheed Martin është disajneri dhe zhvilluesi i gjithë projektit për sistemin e integruar të vëzhgimit ajror. I kam kërkuar që të bëjmë një vlerësim shumë më të mirë të kapaciteteve të sistemit të vëzhgimit ajër-tokë-det,

dhe për t'i integruar ato nënsuazën e gjigandit Lockheed Martin. Gjithashtu kam kërkuar sekretarit Mattis dhe kompanisë Lockheed Martin për të patur një prani të shtuar të investimeve amerikane ushtarake në vendin tonë, e cila është e mirëpritur.

Zëri i Amerikës: Si u përgjigjeni zërave kritikë, që kanë folur për fikjen e qëllimshme të radarëve?

Olta Xhaçka: Tërësisht të pavërta. Radarët nuk fikën. Kjo është e pamundur. Nuk ekziston.

Zëri i Amerikës: Zonja ministre! A ka një mungesë transparence të qeverisjes së Partisë Socialiste, duke përmendur rastin më të fundit, atë të vendosjes së tarifës në rrugën e Kombit, e cila u nxitu dhe atë që opozita e ka quajtur si mosbindje

civile. Qeveria e vendosi tarifën, më pas u tërhoq dhe pranoi që nuk është konsultuar për këtë temë. Si e konsideroni ju këtë?

Olta Xhaçka: Nuk është mungesë transparence. Në fakt ky ka qenë një vendim i dhjetorit 2016. Shpallja e ofertës, gara, konkurrimi, pastaj negociimi i kontratës ka ndodhur në dhjetor 2016. Vlen të thuhet që në 2011 qeveria Berisha pati parashikuar një tarifë edhe më të shtrenjtë mbi 8 euro për përdoruesit e rrugës. Mund të ketë patur probleme të transparencës, ose më mirë të them, të një diskutimi më të mirë me banorët e zonës. Për këtë kryeministri Rama, ministri i transporteve dhe ai i ekonomisë kanë thënë se mund të kishin bërë një punë më të mirë me komunikimin e gjithë detajeve të kontratës. Por ajo është një rrugë shumë e shtrenjtë, për të cilën ende nuk ka përfunduar investimi. Duhet të ishte rruga Durrës - Kukës, por nuk është e tillë. Ajo është një rrugë që kërkon shumë investim jo vetëm për ta mirëmbajtur, por edhe për të përfunduar. Tarifa jonë është më e lirë se e fqinjëve tanë në rajon: Greqia e ka tarifën 0.07 euro për kilometër, Maqedonia e ka 0.06 euro për kilometër, ndërsa Shqipëria është 0.04 euro për kilometër, bashkë me të gjitha masat që kontrata parashikon për banorët që do të jenë përdorues të shpeshtë dhe pa mundësi financiare.

Zëri i Amerikës: Por qeveria u tërhoq dhe tha se do të bëjë një studim për qytetarë e asaj zone...

Olta Xhaçka: Kjo qeveri e ka përparësi interesin e qytetarëve. Për ne është e rëndësishme që të ketë një diskutim publik dhe një konsultim publik për ato që po bëjmë, që gjithë banorët dhe taksapaguesit të kuptojnë rëndësinë e mirëmbajtjes dhe investimit për këto vepra madhore. Këtë qeveria e ka bërë edhe në këtë situatë, e cila ka qenë thellësisht e motivuar nga politika.

Zëri i Amerikës: Por nga ana tjetër, konsultimi mund të ishte bërë përpara, apo jo?

Olta Xhaçka: Kjo është një kontratë e mbyllur qysh në dhjetor 2016, dhe mund të shihet lehtë me një kërkim në internet. Nëse gjatë kësaj kohe nuk është bërë mjaftueshëm për të patur një konsultim publik dhe një informim publik, për këtë kërkim ndjesë. Por për çdo gjë tjetër kemi interesin e banorëve, e taksapaguesve parësor dhe të rëndësishëm për mënyrën se si qeverisim.

Zëri i Amerikës: Falemnderit, zonja ministre!

Sekretari Amerikan i Mbrojtjes

James Mattis: Do të keni gjithmonë ndihmën tonë

Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, gjatë vizitës zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës u prit më 18 prill, nga sekretari i Mbrojtjes, James Mattis

Washington-Shtetet e Bashkuara të Amerikës e vlerësojnë Shqipërinë një aleat të denjë të NATO dhe vend lider në Ballkanin Perëndimor. Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, gjatë vizitës së saj zyrtare në SHBA u prit më 18 prill nga sekretari amerikan i Mbrojtjes James Mattis.

“Shqipëria ka treguar se madhësia e saj gjeografike ka shumë më pak rëndësi, se sa angazhimi i saj në Aleancë. Si një aleate e vendosur, Shqipëria godet më fort se sa pesha e saj”, - deklaroi sekretari Mattis në nisje të takimit mes dy delegacioneve.

Ai falënderoi Shqipërinë për angazhimin në NATO dhe përfshirjen në të gjitha operacionet e Aleancës.

“Ju jeni aleati ynë jo vetëm në uniformë, por në të gjitha aspektet e për këtë do të keni gjithmonë ndihmën tonë”, - vijoi më tej sekretari amerikan i Mbrojtjes.

Ministrja Xhaçka, në emër të qeverisë shqiptare falënderoi sekretarin Mattis për mbështetjen e pazëvendësueshme dhe të madhe që Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë dhënë për Forcat tona të Armatosura për misionet dhe operacionet, mundësitë e arsimit, stërvitjen dhe stërvitjet për personelin tonë ushtarak; ndihmën e zhvillimit të aftësive të cilat kanë qenë të gjitha të rëndësishme për të përgatitur ushtritë tona për sfidat që paraqesin mjedisin e sotëm të sigurisë.

“Ne besojmë se projektimi i stabilitetit është vendimtar për paqen, sigurinë, stabilitetin dhe demokracinë. Ballkani Perëndimor është një rajon i orientuar nga Perëndimi. Ne ndajmë dhe mbrojmë parime dhe vlera të njëjta ndaj mirëpresim forcimin e partneritetit tonë strategjik.”, - nënvizoi ministrja Xhaçka.

Më tej, ministrja e Mbrojtjes u sugjeroi zyrtarëve amerikanë të mbrojtjes të shikojnë mundësinë që Shqipëria të shërbejë si vend kontakti në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Sipas saj, një prani e SHBA ose e NATO mund të ishte një demonstrim i qartë se ky rajon nuk është harruar nga aleatët.

“Ju ftojme ta konsideroni me dashamirësi Shqipërinë si një vend kontakti në rajon. Ne do të vazhdojmë të jemi të angazhuar në rajon dhe do të luajmë padyshim një rol konstruktiv për paqen, sigurinë dhe prosperitetin në zonën tonë. Shtetet e Bashkuara mund të mbështeten tek ne. Ne besojmë se është koha për të parë një gjurmë në Shqipëri. Një prani e SHBA ose e NATO në Shqipëri është një demonstrim i qartë se kjo zonë nuk harrohet nga aleatët tanë. Në funksion të këtij projekti, ne jemi të gatshëm të vëmë në dispozicion bazat tona detare/kapacitetet tona tokësore/ajrore/detare, në mënyrë bilaterale me SHBA ose në kuadrin e NATO. Në të njëjtën kohë dëshirojmë të shohim një rritje të prezencës së industrisë së mbrojtjes amerikane në Shqipëri. Në këtë drejtim, ne do të vlerësojmë mbështetjen dhe rolin tuaj për të promovuar këtë angazhim”, - tha ministrja Xhaçka.

Sekretari amerikan i Mbrojtjes, James Mattis mirëpriti propozimin për ta parë Shqipërinë si një footprint për NATO në rajon dhe vlerësoi se ky propozim vjen në momentin e duhur nga një vend që ka treguar jo vetëm me shifra, por edhe me angazhime se është një aleat i denjë.



Wess Mitchell: Shqipëria është një partner i besueshëm i SHBA -së

Ndihmës Sekretari amerikan i shtetit për Europën dhe Euroazinë, Wess Mitchell priti Ministrën e Mbrojtjes znj. Olta Xhaçka

Ndihmës Sekretari amerikan i shtetit për Europën dhe Euroazinë, Wess Mitchell priti më 17 prill në një takim zyrtar Ministrën e Mbrojtjes znj. Olta Xhaçka. Takimi u zhvillua pak minuta pas deklarates zyrtare të KE, e cila nuk kaloi pa u uruar edhe nga ndihmës sekretari Mitchell i cili u shpreh se dita e sotme është një ditë për tu festuar.

Gjithashtu ndihmës sekretari amerikan i shtetit vlerësoi kontributin e Shqipërisë në NATO duke u shprehur se Shqipëria është një partner i besueshëm i SHBA dhe garant i sigurisë në rajon. Nga ana e saj, ministrja Xhaçka u shpreh se deri në vitin 2024, 2% e GDP do t'i dedikohet mbrojtjes. Ky takim është vazhdim i disa takimeve zyrtare që ministrja e Mbrojtjes po zhvillon në SHBA me ftesë të sekretarit amerikan të Mbrojtjes, James Mattis.



MINISTRJA XHAÇKA NË SENAT DHE NË KONGRESIN AMERIKAN

Xhaçka: Jemi të interesuar për industrinë ushtarake amerikane

Me ftesë të sekretarit amerikan të Mbrojtjes James Mattis, ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka ka nisur më 17 prill, një vizitë zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku po zhvillon një sërë takimesh të rëndësishme në Senat dhe në Kongres.

Në Capitol Hill, ministrja Xhaçka është pritur në një takim të veçantë nga senatorët Tom Cotton dhe kongresmenët Matt Gaetz dhe Jim McGovern. Në këto takime, ministrja Xhaçka vlerësoi mbështetjen e rëndësishme të Shteteve të Bashkuara për reformën në drejtësi, ndërsa diskutoi dhe mbi partneritetin strategjik mes SHBA dhe Shqipërisë. “Mbështetja amerikane është shumë e rëndësishme edhe për axhendën europiane të Shqipërisë”, - tha ajo.

Në vizitën e saj në SHBA, ministrja e Mbrojtjes është takuar dhe me përfaqësues të kompanisë amerikane, Lockheed Martin, kompani elitë në botë në fushën e industrisë ushtarake. Aktualisht “Lockheed Martin”,



po punon për Sistemin e Integruar të Vëzhgimit të hapësirës ajrore shqiptare (SIVHA). Kontrata për blerjen e SIVHA u miratua në nëntor 2017.

Ministrja Xhaçka u shpreh se Sistemi i Integruar për Vëzhgimin e Hapësirës Ajrore është me rëndësi,

jo vetëm për sigurinë kombëtare të Shqipërisë, por për të gjithë aleancën e NATO. “Jemi të interesuar për praninë e investimeve të mëtejshme të industrisë ushtarake amerikane në Shqipëri. Sistemi i integruar për vëzhgimin e hapësirës ajrore është

me rëndësi, jo vetëm për sigurinë kombëtare të Shqipërisë, por për të gjithë aleancën e NATO”, - theksoi Xhaçka. Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka është pritur në një takim të veçantë nga sekretari i Mbrojtjes, James Mattis.

“Të mbajmë pastër tokën që duam”

Çaste pranvere në Garnizonin “Skënderbe”

Sapo kapërcen postbllokun për të hyrë në garnizonin “Skënderbe”, ajo që të bie menjëherë në sy, përveç rojave të shërbimit të cilët ndodhen në pozicionet e tyre përkatëse, është rregulli dhe pastërtia, gjelbërimi dhe mirëmbajtja e ambientit ushtarak që nuk njih stinë dimër, apo verë.

Thënë kjo, pasi gjithçka është nën kontroll jo vetëm për sa i përket sigurisë, gjë që ky institucion e ka primare, por edhe asaj që nënvizuar më lart, një territor i gjithi në harmoni me natyrën, në të gjithë perimetrin dhe sipërfaqen e tij, cep më cep, që nga pemët e shumta që hijeshojnë ambientin, rrugicat që përshkojnë sipërfaqet e gjelbra, e deri tek rrugët ku lëvizin mjetet e institucionit, apo sheshi madhështor në qendër të Garnizonit “Skënderbe”.

Një menaxhim i përkryer i çdo strukture të mirëmbajtjes të kësaj hapësire që i jep kulturë dhe standard garnizonit.

Ajo që na tërhoqi vëmendjen këto ditë, ishte puna e një skuadre ushtarësh të batalionit të Sigurimit të Shtabit të Përgjithshëm të FA.

Ishin pikërisht ushtarë të gjithë pothuaj në të njëjtë moshë të re, siç janë ushtarakët e gradës ushtarë profesionistë, që duke shfrytëzuar momente të kohës së lirë ata po kujdeseshin për të rimbjellë një sipërfaqe të barit të dëmtuar.

Kujdesi dhe mënyra se si punonin, shkriftimi i tokës te ajo pjesë e sipërfaqes të lulishtes si dhe mbjellja nga fillimi e barit, na dha një pamje tjetër më të butë, ndryshe nga ajo që të jep kur ata janë në vend shërbim, seriozë, korrektë dhe pse jo pak hijerëndë në detyrën e tyre teksa ti ndjek gjithmonë krahun e djathtë dhe bën check-in, kur



hyn apo del nga Garnizoni.

Ata atë ditë nuk ishin pjesë e shërbimit të tyre të përditshëm në vend roje, por ne na u dukën sikur ishin pjesë e pranverës.

Prandaj nxituam t'i fotografonim nga larg, (nuk i morëm lejë sigurisht, se nuk do të na lejonin) dhe po i sjellim këto foto në gazetë për t'i ndarë me lexuesin.



KOMANDA MBËSHTETËSE

“Të mbajmë pastër tokën që duam”

Strukturat e Komandës Mbështetëse në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe lokal që prej ditës së djeshme i janë bashkuar aksionit kombëtar të quajtur “Të mbajmë pastër tokën që duam” të cilët kanë nisur njëfushatë pastrimi, veçanërisht në faqet anësore të lumenjve, në pikat kryesore të akteve rrugore. Harta e shtrirjes së këtij aksioni fillon me Prefekturën e Tiranës, Elbasanit, Dibrës, Kuksit, Gjirokastrës dhe përfundon me prefekturën e Korçës, ku vëmendja kryesore është përqendruar me tepër në pastrimin e objekteve me vlera kulturore dhe turistike siç është ura e Brarit në Tiranë, plazhi i Rallnikut në njësinë administrative Pustec Pogradec, si dhe pastrimi i tre segmenteve të lumit Valbona në Bashkinë Tropojë. Në këtë aksion marrin pjesë rreth 140 forca dhe 8 mjete transporti 5 mjete vetëshkarkuese 1 fadromë, si dhe 1 ekskavator. Ky aksion do të zgjasë rreth 1 javë dhe do të finalizohet në datën 22 prill 2018, datë e cila shënon ditën ndërkombëtare të tokës.

BATALIONI I PARË I KËMBËSORISË (B1K) DHE BATALIONI “KOMANDO”

220 trupa dhe 15 mjete, kanë filluar pastrimin e territorit

Efektivët e Forcës Tokësore, i janë bashkuar në aksionit kombëtar “Të mbajmë pastër tokën që duam”. Që në orët e para të mëngjesit të datës 16 prill, rreth 220 trupa dhe 15 mjete, kanë filluar pastrimin e territorit të vendit në pikat më nevralgjike të tij. Operacioni u zhvillua në bashkëpunim të ngushtë me pushtetin vendor të prefekturave Tiranë, Shkodër, Berat.

Më konkretisht efektivat e Batalionit të Parë të Këmbësorisë (b1k) dhe ata të Batalionit “Komando” të Forcës Tokësore, kanë vepruar në Prefekturën e Shkodrës me fokus kryesor zonën e Lezhës në pjesën e plazhit, si dhe monumentet e kulturës siç është Ura e Mesit në Njësinë Administrative Postribë. Batalioni i Tretë i Këmbësorisë së Forcës Tokësore (b3k), u fokusua në pastrimin e brigjeve të lumenjve Shkumbin dhe Osum. Prefektura e Tiranës, gjeti të angazhuar në këtë ak-



sion mbarëkombëtar trupat dhe mjetet e batalionit të Mbështetjes me Luftim të Forcës Tokësore, të cilët janë shpërndarë në zonën e Bashkisë së Kamzës dhe

asaj të Vorës. “Tokësorët”, ngelen të angazhuar për pastrimin e territorit deri në përfundim të aksionit kombëtar me datë 22 prill.

FORCA DETARE

Mbështetje për pastrimin e përrenjve dhe të lumenjve

Bazuar në planin e veprimit për pastrimin e përrenjve dhe lumenjve në datat 16-22 prill 2018, strukturat e Forcës Detare me efektiv prej 30 vetash dhe dy mjete, filluan operacionin e pastrimit në segmentin ura e Gjolës të Bashkisë Fushë-Krujë. Koordinimi u realizua me Institucionin e Prefektit Durrës, Inspektoratin Mjedisor dhe Bashkinë Krujë. Gjithashtu me 20 forca dhe një mjet vazhdon pastrimi në vijën bregdetare të Parkut Kombëtar të Orikut Flotilja Detare Pashaliman.



Gjeneral Kollçaku priti homologun maqedonas gjeneral Velichkovski

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku priti në Shtabin e Përgjithshëm, ditën e mërkurë, më 18 prill 2018, në një takim të veçantë shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Maqedonisë, gjeneral lejtënant Metodija Velichkovski dhe delegacionin që e shoqëronte. Pas pritjes ceremoniale të dy delegacionet zhvilluan bisedime për çështje me interes reciprok, që përfshijnë çështje në marrëdhëniet bilaterale në kuadrin rajonal dhe atë të Aleancës.

Gjeneral brigade Kollçaku, pasi i uroi mirëseardhjen homologut të tij maqedonas, vlerësoi si shumë të rëndësishëm bashkëpunimin ushtarak dypalësh për sigurinë dhe stabilitetin e dy vendeve dhe rajonit, duke theksuar se Shqipëria e konsideron Maqedoninë një partner të rëndësishëm në kuadër të bashkëpunimit për mbrojtjen dhe sigurinë dhe se FA shqiptare do të vazhdojë të mbështesë përpjekjet e Maqedonisë për integrimin në NATO. Nga ana e tij, gjenerallejtënant Velichkovski, e falënderoi gjeneral brigade Kollçakun për mikpritjen dhe vlerësoi me nota të larta mbështetjen që Shqipëria dhe Forcat e Armatosura shqiptare kanë dhënë e po japin në integrimin e Maqedonisë në NATO. Në përfundim të takimit, bashkëbiseduesit ndanë të njëjtin mendim që bashkëpunimi ndërmjet Forcave të Armatosura shqiptare dhe Forcave të Armatosura maqedonase do të vijojë edhe më tej, me qëllim sigurinë dhe stabilitetin e dy vendeve por edhe të rajonit, për të qenë të aftë tu përgjigjen sfidave të kohës.

FA mbështet integrimin e Maqedonisë në NATO



Gjeneral brigade Kollçaku vlerësoi si shumë të rëndësishëm bashkëpunimin ushtarak dypalësh për sigurinë dhe stabilitetin e dy vendeve dhe rajonit, duke theksuar se Shqipëria e konsideron Maqedoninë një partner të rëndësishëm në kuadër të bashkëpunimit për mbrojtjen dhe sigurinë dhe se FA shqiptare do të vazhdojë të mbështesë përpjekjet e Maqedonisë për integrimin në NATO.



GJENERALE SHEHU PRITI ATASHEUN FRANCEZ KOLONEL FABRICE DUDA

Shumë i mirë bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes

Zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjenerale brigade Manushaqe Shehu, priti më 11 prill 2018, në një takim atasheun ushtarak francez, jo rezident në vendin tonë, kolonel Fabrice Duda, me kërkesë të këtij të fundit për marrjen e një feedback-u, për pjesëmarrjen në "Takimi i sesionit të 12-të ndërkombëtar Evropë-Rajoni Mesdheut", zhvilluar në Paris, Francë gjatë muajit shkurt 2018.

Gjenerale brigade Shehu, pasi e uroi atasheun francez për mirëseardhjen në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, vlerësoi bashkëpunimin shumë të mirë midis dy vendeve, dhe në këtë kuadër bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes, sidomos në fushën e arsimit.

Ajo falënderoi Ambasadën Franceze për mbështetjen e Forcave të



Armatosura shqiptare për pjesëmarrjen e saj në një aktivitet kaq të rëndësishëm që u zhvillua në kuadër të Iniciativës "The Mediterranean of the future conditions for a new equilibrium", si dhe vlerësoi me nota mjaft pozitive pjesëmarrjen në këtë aktivitet, punën e lektorëve, duke u ndalur në detaje të veçanta të zhvillimit të konferencës.

Nga ana e tij atasheu ushtarak francez, kolonel Fabrice Duda e falënderoi gjenerale brigade Shehun për pritjen dhe feedback-un e bërë për pjesëmarrje në këtë konferencë në Paris, si dhe konfirmoi se edhe vitin tjetër Ambasada Franceze do të ofrojë dy pjesëmarrës në të njëjtën konferencë.

Në përmbyllje të takimit, gjenerale brigade Shehu theksoi se ky kurs është shumë i vlefshëm dhe se pjesëmarrja e personelit ushtarak të Forcave të Armatosura shqiptare edhe në konferenca të tjera të këtij niveli është me vlera pozitive.

Shefi i Shtabit të Ushtrisë Maqedonase

Gjeneral Lejtnant Velichkovski viziton Komandën e Forcës Detare

Në zbatim të planit të bashkëpunimit midis Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Ushtrisë të Maqedonisë, me date 18 prill, në Komandën e Forcës Detare zhvilloi një vizitë zyrtare, Shefi i Shtabit të Ushtrisë Maqedonase, Gjeneral Lejtnant Metodija Velichkovski, i shoqëruar nga stafi i tij më i ngushtë.

Fillimisht Gjeneral Velichkovski u prit nga Komandanti i Forcës Detare, Gjeneral major Ylber Dogjani dhe truproja e nderit e Forcës Detare.

Më pas gjatë takimit të përbashkët, Zoti Dogjani i uroi mirëseardhjen në Shqipëri, Shefit të Shtabit të Ushtrisë maqedonase, ku nënvizoi miqësinë tradicionale midis dy popujve tanë, si dhe bashkëpunimin e frytshëm midis Forcës sonë Detare dhe Forcave të Armatosura të Maqedonisë, për trajnimin disa



vite me pare të zhytsave pranë Qendër të Zhytjes FD. Nga ana e tij, Gjeneral Velichkovski, shprehu mirënjohjen për pritjen e afuar nga Forca Detare Shqiptare, si dhe gatishmërinë e ofruar për të bashkëpunuar në fusha me interes reciprok në të ardhmen. Në vijim të vizitës, ushtarakët e lartë të shtetit maqedonas bënë një lundrim të shkurtër në Gjirin e Durrësit, me anijen "Iliria", P-131.

FIGALI GOLEMI
Dega e Bashkëpunimit Civilo
Ushtarak në Focën Ajrore

Histori suksesi e Aviacionit Ushtarak Shqiptar

Gjurmë historike, 67 vjet Aviacioni Ushtarak Shqiptar

Këtë 24 prill Forcave Ajrore bëhen 67 vjeçare. Aviatorët që shtëpinë e kanë “në ajër” kanë shkruar histori suksesi midis tokës dhe ajrit, në “kështjellën” 67 vjeçare të ngjarjeve, sakrificave, përkushtimit, djersës e gjakut në roje të hapësirës qiellore. Forcat Ajrore janë armë luftarake e njohur e shqiptarëve, janë dhe do mbeten “psherëtimë e bardhë” e shekujve. Pilotët, këta bij të shqipërisë, që në vitin 1945 fluturuan mbi qiejt e ish-Jugosllavisë dhe më tej mbi stepat e Rusisë dhe mbi qiejt e Kinës. Në më shumë se tre dekada Akademia e Aviacionit ka dhënë një kontribut të veçantë në përgatitjen 1300 pilotëve dhe teknikë e specialistë që shërbyen denjësisht në aviacionin ushtarak shqiptar. Ata ishin dhe mbetën zotër të ajrit me përgatitje teorike e praktike, me përsosmëri të teknikave të fluturimit, me zotësi profesionale të admirueshme në fluturim me avionë e helikopterë. Në mbi gjashtë dekada e gjysmëpilotat kanë “pushtuar” me zotësi në hapësirën qiellore në hapësirën administrative shqiptare.

Hapat e parë të Aviacionit në Shqipëri

Hapësira qiellore shqiptare është “pushtuar” nga bijtë e saj. Përpjekjet shqiptare për të organizuar Aviacionin Ushtarak zënë fill që në vitin 1920 në Shqipëri. Ish-Ministri i Luftës Selaudin Sahip Shkoza i dërguar në Shqipëri nga Mustafa Qemal Ataturku, shprehte shqetësimin në një dokument zyrtar datës 9.9.1921, se “tani për tani nuk mundemi të blejmë aeroplana”. Fakt është se Shqipërisë i mungonte infrastruktura rrugore dhe hekurudhore dhe nuk bëhej fjalë për aviacion. Më 1924 Shqipëria nënshkroi meshoqëriajrore gjermane “Lufthansa”, një marrëveshje koncensionare 10-vjeçare për aviacionin. Më 1925 u krijua shoqëria e përbashkët shqiptaro-gjermane, “Adria Aero Lloyd”, që i filloi fluturimet me destinacion Vlorën dhe Shkodrën, me dy avionë “Albatros”. Në vitin 1927, kjo shoqëri u ble nga zyra e aviacionit civil nga shoqëria italiane mesdhetare, e cila drejtohej nga ministria e Ajrit të Italisë, gjë që çoi në zgjerimin e fluturimeve në qytetet të tjera si Elbasani, Korça, Kukësi, Peshkopia e Gjirokastra. Njëkohësisht u hapën dhe linjat ndërkombëtare me Romën, Milanon, Selanikun, Sofjen, Beogradin, Podgoricën. Në fillim të vitit 1928 u përrua linja e parë ndërkombëtare Brindisi-Vlorë-Brindisi. Në nëntor 1929 u dekretua “Ligji mbi organizimin e Fuqive Armate”, ku ushtria emërtohej “Ushtria Kombëtare Shqiptare” dhe ndahej në “Fuqitë Tokësore, Detare e Ajrore”. Por Forcat Ajrore nuk arritën të krijohen, edhe pse formalisht ajo ishte edhe në tri dekretet e viteve 1931, 1934 dhe 1937. Disa avionë austro-hungarezë dhe italianë të mbetur në vend që nga Lufta e Parë Botërore u bënë zanafilla e krijimit të aviacionit. Më 1931 fillojnë linjë e re e transportit ajror të brendshëm me avionë të rinj, në vitin 1932 shoqëria italiane “Ala-Litoria” kreu transport ajror me hidroplan në linjat Durrës-Bari dhe Vlorë-Brindisi, ndërsa në 1938 filloi linja Tiranë-Beograd-Podgoricë-Tiranë. Ndërsa në maj 1940 linja Milano-Ankona-Bari-Tiranë-Bari-Ankona-Milano. Disa oficerë shqiptarë të diplomuar në Akademitë Ushtarake të Aviacionit në Francë dhe Itali bënë



përpjekjet e para për të ngritur avionët e mbetur nga Lufta e Parë Botërore në vitet ‘20-ë të shekXX. Për të drejtuar avionët u vendosën pilotët shqiptarë të përgatitur në ushtri të huaja. Avni Xhelili nga Leskoviku kishte përfunduar shkollën për pilot në Gjermani për interes të Perandorisë Osmane, ishte një nga pilotët e parë shqiptarë që ngriti në fluturim avionët e mbetur. Ai ka hyrë në kujtesën kombëtare sepse pilotonte dy avionë italianë të mbetur në Vlorë që në vitin 1920. Përpjekjet e Faik Qukut, Avni Xhelilit, Hysen Borovina, Abdulla Muzhaku etj, për aviacionin ushtarak ishin maksimale, por nuk u mundësua krijimi i aviacionit sepse qeverisës shqiptarë e asaj kohe i mungonin mundësitë financiare për blerje avionësh. Në Milano dhe vende të tjera europiane u përgatitën pilotë shqiptarë që shërbyen në flotat ajrore të vendeve të tjera.

Pilotët veteran të aviacionit ushtarak, ish-partizanë të LANÇ-it

Pilotat e parë të pasluftës ishin nga radhët e partizanëve shqiptarë. Ata filluan të përgatiten që në vitin 1945 në ish-Jugosllavi dhe në Akademitë e Aviacionit Sovjetik. Partizanët shqiptarë të përzgjedhur pas një luftë 5-vjeçare ishin të parët pas LIIB, që shkonin në “aristokracinë” e aeronautikës ballkanike. Ish-partizanë që shkuan në Jugosllavi të parët ishin: Babaçe Faiku, Edip Ohri, Zyhdri Rada, Sazan Xhelo, Irakli Grazhdani, Dilaver Radëshi, Niko Hoxha, Fari Bubësi, Pertef Myftari, Ibish Vokshi, Masar Aga, Vasil Gjikonji, Beqir Dibra, Koço Karoli, Zenel Minarolli etj. Ata studiuan në shkollën e aeronautikës jugosllave deri më 17.7.1948, ku u specializuan vetëm për aeroplanin “JAK-3”, si dhe disa kursantë u përgatitën për shturmanë bombardues dhe avionë transporti. Më 14.2.1947 është krijuar kompania

e VAIN-it, për vrojtimin e Hapësirës Ajrore dhe informimin për objektet e zbuluara. Përgatitja do vijonte në BS edhe tre vjet, nga viti 1948 deri në vitin 1951, me aeroplanin “JAK-3”, avion luftarak i pajisur me predha dhe bomba. Akademitë ajrore ku studiuan shqiptarët për pilotë dhe teknikë avionësh ishin në Moskë, në Harkov të Ukrainës, në Grozni të Çeçenisë, në qytetin Engels të qarkut të Saratovit, në shkollën “Shkallov” të qytetit Shkallov, në Stalingrad, Novosibirsk, Krasnodar, Armaviretj, në kuadrin e bllokut ushtarak të lindjes “Traktati i Varshavës”. Studentët shqiptarë qënishin aventurën ajrore në emër të Shqipërisë, duke fluturuar përmbi stepat ruse ishin: Babaçe Faiku, Petraq (Peço) Polena, Irakli Grazhdani, Pertef Myftari, Hasan Shyti, Estref Shehu, Mati Baba, Vaso

që kushtet e reja ëndërra e pilotimit ushtarak shqiptar vazhdon. Pilotët tanë trajnohen e sukses në SHBA, Turqi, Francë, Britani, Spanjë etj.

Piloti Peço Polena më 24.4.1951 fluturoi për herë të parë me një avion ushtarak shqiptar

Aviacioni Luftarak Shqiptar është krijuar më 24 prill 1951. Kjo datë është gdhendur në kujtesën e memories kombëtare shqiptare dhe fillon me fluturimin e parë të një avioni ushtarak të shtetit shqiptar, të pilotuar nga piloti korçar Petraq (Peço) Polena. Ai ishte piloti i parë që “preku” qiellin shqiptar me avion ushtarak në roje të hapësirës ajrore në prani të personaliteteve më të larta shtetërore. Reparti i parë ushtarak i aviacionit u krijua në Tiranë në vitin



Kosti, Vasil Trasha, Thanas Gjikonji, Vasil Gjikonji, Zenel Minarolli, Areteo Ikonimi, Mili Gërbizi. Pas kthimit në atdhe, krijuan aviacionin shqiptar dhe i dhanë jetë një arme të re e të dashur, armës së aviacionit. Ishin pilotët e parë të aviacionit ushtarak që krijuan atë që sot quhet “emblemë e historisë së aviacionit”, ata që shkruan faqe heroizmi dhe guximi të pilotimit ushtarak përtej aventurave të ajrit. Misionarët e ruajtjes së hapësirës ajrore shqiptare në 67 vjet shkruan histori suksesi; ndërkohë

1951, në Aerodromin e Laprakës me komandant pilotin Babaçe Faiku, i cili u bë më vonë edhe piloti i parë i avioni qeveritar të asaj kohe. Regjimenti i parë i Aviacionit Reaktiv u krijua në vitin 1955 në Kuçovë. Ai do të pasohet më pas me krijimin e Repartit të Transportit Ushtarak në Tiranë, Regjimentin e Rinanit, Shkollën e Aviacionit, Regjimentin e Helikopterëve, Regjimentin e Gjadrit, të gjithë me avionë e helikopterë të prodhimit lindor. Në grupin e pilotëve që fluturonin të klasit të parë, në vitin

1964 bënë pjesë: Gëzdar Veipi, Çobo Skënderi, Anastas Ngjela, Lulo Musai, Kosta Dede, Mahmut Hysa, Bajazit Jaho e Halit Bulku. Në vitet ‘70-‘80, sundimtarët e kupolës qiellore shqiptare ishte aviacioni luftarak, i cilikishte mbi 95 avionë MIG-19, 12 avionë MIG-21, 12 avionë MIG-17, 24 avionë MIG-15 luftarakë-mësimorë, 4 avionë transporti IL-14 për transport qeveritar, apo për studime ushtarake dhe gjeografike; 1 avion bombardues IL-28 (fillimisht rus por që në 1971 u ndërrua me një kinez); 36 helikopterë MI-4; 12 avionë AN-2 transporti; 12 Avionë JAK-18; 12 Avionë PO-2 si dhe 1 oficinë për riparim kapital të gjithë tipave të avionëve. Në Aerodromin e Laprakës në Tiranë ishin të dislokuar edhe 12 avionë transporti të lehtë AN-2 për transport trupash, apo në ndihmë të ekonomisë, ndërsa në Shkollën e Lartë të Aviacionit në Vlorë, veç avionëve reaktivë MIG-15 kishte edhe dy skuadrilje me avionë me helikë “JAK-81”, që shërbenin për përgatitjen e pilotëve në vitin e parë të kualifikimit si pilot. Në vitin 1976, pas shkëputjes nga Kina, Shqipëria kishte 240 mjete fluturuese: 150 avionë dhe 90 helikopterë. Në paradën e 30 vjetorit të çlirimit, më datë 29.11.1974 kanë parakaluar në bulevardin “Dëshmorët e Kombit” 27 avionë reaktivë luftarakë. Gjatë gjithë historisë së aviacionit shqiptar që nga krijimi i tij zyrtar më 24.4.1951 kanë rënë në krye të detyrës 38 pilotë dhe janë shpallur “Dëshmorët të Atdheut”. Piloti i parë i rënë në vitin 1947 është Ibush Vokshi dhe i fundit i rënë është Jani Tarifa, pas rënies së avioni të tij luftarak MIG-19, më 16 shtator 2004. Pas kësaj ngjarje të rëndë Ministri i Mbrojtjes i asaj kohe P. Majko pezulloi gjitha fluturimet me avionë MIG, dhe në 2005 gjithë avionët ushtarakë u nxorrën nga përdorimi. Pistat e aerodromet janë “shtëpia” e infrastrukturës së pilotave. Aerodromi i Laprakës në Tiranë u ndërtua pranë Kroit të “Shën Gjergjit” në vitet ‘30. Ai ishte një aerodrom modern, me dy hangarë të mëdhenj, konstruktion metalik për strehim të avionëve, me pistë betoni për ulje dhe ngritje, i elektrifikuar për fluturime natën dhe i kanalizuar në mënyrë të përsosur. Më tej në historikun e pistave dhe aerodromeve njihet ajo e Shijakut ose Fusha e Belikut, e ndërtuar gjatë LIIB, Aerodromi i Shkodrës në Vukshqeraj dhe në livadhet e Sulçe Bej Bushatit, fusha e Shtojt; Aerodromi i Kukësit, i Korçës, i Gjirokastrës në Valare, i Vlorës, Aerodromi i Rinanit është aeroporti më modern në Shqipëri i ndërtuar më 1954, i Kuçovës, i Gjadrit ose Zadrimës, ndërtuar më 1975 për uljen dhe ngritjen e avionëve ushtarakë dhe ishte një nga më modernët e ushtrisë shqiptare, që u



përdor me sukses edhe nga avionët e NATO-s në vitin 1999.

Bashkë në çdo apel të aviatorëve ushtarakë

Forca Ajrore shqiptare e ka bërë traditë që në çdo datë 24 prill në mënyrë të përvitshme ta ketë edhe njëdatë apeli dhe kujtesë të aviacionit. Në të gjitha bazat ushtarake ajrore në Forcat Ajrore kujtohen pilotët që e mbuluan me lavdi Aviacionin luftarak shqiptar, kujtohen ata që derdhën djersën dhe gjakun për aviacionin, kujtohen veçanërisht ata që prehen në altar të kombit, dëshmorët e Forcave ajrore. Janë ata që shkruan histori trimërie në qiejt e Shqipërisë janë: Ibush Vokshi rënë në vitin 1947, Qemal Mërtiri rënë në vitin 1952; Vasil Trasha rënë më 23.03.1958, Hektor Lakoni rënë më 23.03.1962, Sokrat Basha rënë më 17.06.1963, Niko Hoxha rënë më 20.11.1965, Jovan Kaçorin rënë më 27.06.1960, Stilian Tanku rënë më 27.09.1967, Muharrem Hida rënë në vitin 1970, Refik Jazo rënë në vitin 1970, Kaso Petroshti rënë më 06.05.1971, Shyqyri Balla rënë më 06.05.1971, Azbi Serani rënë më 04.10.1972, Islam Mani rënë në vitin 1973, Bego Hoxha rënë më 16.03.1974, Dhimitër Robo rënë më qershor të vitit 1974, Veiz Kovaçi rënë më 06.08.1974, Sefedin Tomçini rënë më 07.06.1974, Vasil Noni rënë më 15.08.1978, Shpëtim Sula rënë më 30.8.1979, Sabri Toçi rënë më 29.03.1980, Armando Gjoka rënë më 29.03.1980, Luto Sadikaj rënë më 27.03.191982, Ndue Logu rënë në shtator 1986, Haki Skuqi rënë më 22.10.1986, Agron Galanxhi rënë më 22.11.1989, Enver Hakarënë më 22.11.1989, Pandeli Zhupa rënë më 22.11.1989, Tafil Agai rënë më 22.11.1989, Vangjel Postoli rënë më 22.11.1989, Veledin Resuli rënë më 22.11.1989, Eduart Kostëdhima rënë më 21.03.1991, Fluturim Molla rënë më 21.03.1991, Idriz Hoxha rënë më 20.08.1993, Jani Tarifa rënë në vitin 2005, Vangjel Çondi rënë në vitin 2008, Demush Heba rënë në vitin 2008, Qemal Koni rënë në vitin 2008. Janë dëshmorët e ajrit që "vulosën", me jetën e tyre përjetësinë e Forcës Ajrore, me jetën e tyre midis tokës dhe ajrit që shkruan histori në roje të hapësirës ajrore.

Pilotët-aseti 67 vjeçar i Forcave të Armatosura Shqiptare

Pilotët që shërbejnë sot në Forcat Ajrore janë një aset i çmuar i Forcave të Armatosura dhe i shtetit shqiptar. Muaji prill natyrisht na çon tek ngjarje dhe histori të aviacionit dhe pilotimit ushtarak. Gjithë arsenalit i gjysëmshkullit të kaluar i tejmbushur me avionë e helikopterë në të gjitha bazat e aviacionit ushtarak shqiptar, pasi shkruan epope sukses me performancën brilante të pilotave ja kanë dorzuar "stafetën" një brezi tjetër, po aq i apasionuar sa

brezi i parë i pilotave. Vëmendja e lidershit politik ushtarak dhe e shtetit ka sjellë sot teknikë e teknologji nga më të përparuarat. Ushtarakët e Forcave Ajrore i dhanë jetë një teknologjie të re pasi u pajisën me helikopterë. Pilotët sot shërbejnë me devocion në misione nga më të vështirët me profesionizëm duke zgjidhur detyra në situata nga më komplekset. Krahas detyrave ka vijuar trainimi me plan perspektiv. Pilotët shqiptarë janë përzgjedhur dhe kanë shkuar në Angli ku edhe janë testuar. Në vitin 2011-2012 testusi i kompanisë "FB Helisevices" Tony Oconer, përzgjedhi 12 pilotë shqiptarë që do trajnoheshin për helikopterin Cougar në Francë dhe më pas në Britani të Madhe për IFR. Pilotët e përzgjedhur kryen në vitin 2011-2013 kursin në helikopterin Cougar në Francë pranë "Eurocopter" dhe më pas atë SAR dhe IFR në Britani

Kaloshi dhe kapiten Denard Kocileri, ndërsa për EC-145 Major Julian Dulemata dhe kapiten Florian Delia. Komanda e Forcave Ajrore në 67 vjet është drejtuar ngathtë ushtarakë: Edip Ohri, Bardhyl Taçi, Klement Aliko, Perlat Binaj, Astrit Jaupi, Dhori Spirollari, Ferdinand Beltojadhe Vladimir Avdiaj. Ndërsa komandantët e Mbrojtjes Kundërajrore dhe të AKA-së në vite kanë qenë: Gjini Marku, Sotir Filto, Hito Çako, Arif Hasko, Todi Naço, Edip Ohri, Babaçe Faiku, Haki Jupasi, Harilla Rebi, Perlat Sula, Aqif Cikallesi. Në Shqipëri në 67 vjet ka pasur tetë raste që kanë katapultuar, ndërsa në fakt vetëm katër kanë shpëtuar nga hedhja me katapultë. Nën qetësinë, sigurinë dhe seriozitetin e Komandës së Forcës Ajrore qëndron një jetë ushtarake mjaft aktive që gjallon jo në mënyrë të zakonshme. Këtu është merak i punës, operacionaliteti drejtimit,



të Madhe. Katër helikopter "Cougar" në versionet "SAR", "Medavac" si dhe Helikopter për transport trupash dhe ngarkesash të ndryshme janë tashmë në dispozicion të Forcës Ajrore. Pilotët e Forcave Ajrore janë aktualisht më të trajnuarit të cilët kryejnë të gjitha llojet e fluturimit, natën, ditën dhe në kushte të vështira (IFR) madje për herë të parë në historinë e FA këta pilotë po kryenin fluturime edhe jashtë Shqipërisë si në: Mal të Zi, Kroaci, Greqi, Kosovë. Emri më i ri i helikopterëve "Cougar", "EC 145", drejtohen me kopetencë si: N/Kolonel Altin Lama, Major Dritan Durmishaj, Major Dritan Durmishaj, Major Agim Sallaku, Major Eduart Koçi, Major Çlirim Plaku, Major Luan Sadiku, Kapiten Ervin Buzi, Kapiten Klajdi Tushe dhe Kapiten Aurel Agolli. Në Shqipëri janë trajnuar me instruktorin francez për "COUGAR" pilotët Kapiten Bedri Kaloshi dhe Kapiten Denard Kocileri. Pilotët që fluturojnë me "EC-145" janë: N/Kolonel Kuto Hasani, Kapiten Ervin Buzi, Kapiten Florian Delia, Major Julian Dulemata. Forca Ajrore i kushton rëndësi dhe përgatitjes së pilotëve të rinj të vazhdimësisë në traditën e bukur të fluturimit, si për Cougar, Kapiten Bedri

karakteristika gjithëvjetore në Forcat Ajrore, ku shtabi i ajrorëve harmonizon detyrimet institucionale, udhëheq, drejton, komunikon në formatin perëndimor euroatlantik. Pilotët sot kryejnë detyra nga më komplekset dhe më të vështirat.



Ata ecin në gjurmët e pilotave të talentuar Gëzim Ismaili, Fatmir Zyfi, Bashkim Malaj, Gëzdar Veipi, Agim Matraku e qindra të tjerë. Për të qenë të integrueshëm e bashkëpunues si dhe të gatshëm dhe

operacionalë në çdo kohë trainimi është e vetmja rrugë për t'u ndjerë të barabartë mes të barabartëve. Pilotët tanë janë tashmë zotër të teknikës më të re që ka në dispozicion Baza Ajrore e Farkës si strukturë e rëndësishme e Komandës së Forcës Ajrore, ku kryhet me përkushtim dhe profesionalizëm detyrat e ngarkuara që rrjedhin nga misioni. Është fakt se me anëtarësimin e plotë të Shqipërisë në NATO, para 6 vjetësh, prioritetet dhe objektivat e Forcës Ajrore janë orientuar drejt përbushjes së standardeve të fluturimit, përgatitja e personelit për të qenë i aftë për të punuar me të njëjtat standarde si vendet e NATO-s, si dhe bashkëpunimi dhe realizimi i stërvitjeve të përbashkëta, me qëllim shkëmbimin e eksperiencës në fushën ushtarake. Me anë të realizimit të këtyre trajnimeve si në shkollat perëndimore, Forca Ajrore Shqiptare kanë krijuar grupin e pilotëve plotësisht të ndërveprueshëm dhe të integrueshëm në operacionet e NATO-s, si dhe siguron vazhdimësinë e përgatitjes së pilotëve të tjerë në këto nivele brenda vendit. Përveç këtij grupi kalimi, në Bazën Ajrore Farkë ka filluar edhe programi i trajnimit për pilotët të cilët kalojnë nga një tip helikopteri në tjetrin. Për realizimin sa më mirë të misionit nga efektiviteti i mirëmbajtjes së teknikës ajrore kërkohet rritje e nivelit tekniko-profesional, me synim kryerjen e plotë të punimeve të mirëmbajtjes së nivelit "Flight Line", ndjekja e kurseve "On Job Training", si dhe vazhdimi i trajnimit institucional pranë kompanisë "Eurocopter" dhe entete të tjera të çertifikuara në sinkron me trainimin e efektivitetit fluturues. Personeli i mirëmbajtjes së helikopterëve është trajnuar në

drës së Situatës Ajrore në Bazën Ajrore në Farkë, duke ndikuar në mbarëvajtjen e programit stërvitor. Janë gjithsej 10 kontrollorë ajrore që zhvillojnë shërbim gatishmërie lindje-perëndim dielli, dhe në planet afatshkurtra synohet futja në operacionalitet të plotë dhe mbajtja në gatishmëri 24 orë në shtatë ditë të javës, e kësaj qendre. Kjo qendër ka si mision të saj mbështetjen me asistencë në lidhje me trafikun ajror gjatë kohës së shërbimit, me qëllim harmonizimin dhe sigurimin e mjeteve fluturuese të Bazës Ajrore Farkë, apo edhe të bazave të tjera. Komunikimi në këtë qendër kryhet sipas STANAG-eve të përcaktuara, si dhe manualeve të ICAO për komunikimin dhe menaxhimin e trafikut ajror. Fakt është se pilotët ushtarakë shqiptarë në 67 vjet janë bërë pjesë e ëndërrës botërore të fluturimit. Ata janë roje të hapësirës ajrore në funksion të misionit kushtetues të Republikës së Shqipërisë. Komanda e Forcës Ajrore me profesionalizëm vijon misionin e saj me Komandën dhe shtabin e FA, Bazën Ajrore Farkë, Bazën Ajrore Kuçovë, Qendrën e Vëzhgimit Ajror, Shërbimin Metrologjik Ushtarak dhe Kompaninë e Mbështetjes. Për Forcat Ajrore: "Misioni vazhdon...": "Sigurimi i kapaciteteve të nevojshme për vëzhgimin dhe kontrollin e sovranitetit të hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me NATO, mbështetjen në operacionet luftarake e joluftarake, HNS dhe ato të kërkim-shpëtim SAR, si dhe realizimin e komandim-kontrollit të mjeteve ajrore në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë", nga ku rrjedhin edhe detyrat:

Radarët-"sytë" e Forcës Ajrore, kapacitete të kontrollit të sovranitetit të hapësirës ajrore

Sot, Forca Ajrore Shqiptare është në procesin e saj natyral të modernizimit, duke përfshirë helikopterët Cougar, BO-105, AB-206 etj. FASH do të jenë një forcë e orientuar në rolin aerotransportues dhe atë mbështetës të dy armëve të tjera FT dhe FD. Regjimenti i Helikopterëve i dislokuar në Bazën Ajrore Farkë do të zgjerohet dhe do të pajiset me helikopterë të mesëm me aftësi të transportit të rëndë dhe aftësi për kryerjen e operacioneve "Kërkim-dhe-Shpëtim" (SAR). Efikasiteti i një Force Ajrore lidhet edhe me rëndësinë në përdorimin e radarëve, të cilët janë "sytë" e Forcës Ajrore. Rëndësia e këtij sistemi objekt-zbulimi qëndron në përdorimin e valëve të radios për të përcaktuar distancat, lartësitë, drejtimin ose shpejtësinë e objekteve. Radarët mund të përdoren për të zbuluar aeroplanë, anijet, anije kozmike, raketa, mjete motorike, formacionet e motit dhe terrenit. Gjithashtu radari ndihmon në drejtimin dhe mjeteve ajrore përgjatë operacione ushtarake por jo vetëm. Ka një ndikim të madh në lajmerimin e hershëm ajror, vlerësimin e të dhënave, marrjen e informacionit të saktë në një kohë relativisht të shkurtër, në mënyrë që të gjithë elementët e Qendrës së Kontrollit Raportimit/ mjeteve ajrore ushtarake të kenë efikasitetin më të madh të mundshëm në përbushjen me sukses të çdo misioni që do të kryejnë. Radari në bashkëveprim me elementëve të tjerë mbrojtjes ajrore, përbëjnë atë që quhet fuqia ajrore dhe në bazë të tyre arrihet të kryhet dhe misioni i Forcës Ajrore të Republikës së Shqipërisë. Sigurimi i kapaciteteve të nevojshme për vëzhgimin dhe kontrollin e sovranitetit të hapësirës ajrore të Shqipërisë në bashkëpunim me NATO, mbështetjen në operacionet luftarake e joluftarake, HNS dhe ato të kërkim-shpëtim SAR, si dhe realizimin e komandim-kontrollit të mjeteve ajrore në hapësirën ajrore shqiptare.

Nga vizita e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s Jens Stoltenberg në Ankara

MSC. MIMOZA GOLIKJA

NATO qëndron në solidaritet me Turqinë

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg e falënderoi Turqinë për kontributet e saj thelbësore në Aleancë gjatë vizitës së tij në Ankara të hënën më 16 prill 2018. Sekretari i Përgjithshëm u takua me Presidentin Rexhep Tajip Erdoan, me të cilin diskutuan përgatitjet për Samitin e Brukselit në korrik dhe diskutuan sfidat aktuale të sigurisë.

Në takim me Ministrin e Jashtëm Mevlüt Çavuşoğlu, Sekretari i Përgjithshëm vlerësoi kontributet e Turqisë në operacionet e NATO-s, duke përfshirë ato në Afganistan dhe në Kosovë, si dhe në luftën kundër ISIS. "NATO qëndron me ju në solidaritet," theksoi ai, duke vënë në dukje mënyrat në të cilat Aleanca kontribuon në sigurinë e Turqisë.

"Ne mbështesim Turqinë me masa sigurie, duke përfshirë avionët e mbikëqyrjes AWACS, patrullat detare dhe ushtrimet", tha Stoltenberg. Ai theksoi se sistemet e NATO-s për mbrojtjen e ajrit dhe të raketave ndihmojnë në mbrojtjen e Turqisë dhe Aleanca ka siguruar miliarda në financimin e infrastrukturës ushtarake në vend.

Ministri i Jashtëm Çavuşoğlu dhe Sekretari i Përgjithshëm diskutuan gjithashtu situatën në Siri, përfshirë Operacionin Dega e Ullirit dhe sulmin e tmerrshëm me armë kimike në Douma. "NATO dënon ashpër përdorimin e vazhdueshëm të armëve kimike nga regjimi sirian, si një kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare", tha Stoltenberg. Ai shtoi se përgjegjësit duhet të mbahen përgjegjës dhe NATO mbështet plotësisht përpjekjet e udhëhequra nga Kombet e Bashkuara për të arritur një zgjidhje të qëndrueshme politike në Siri.

Gjatë vizitës së tij, Sekretari i Përgjithshëm u takua gjithashtu me ministrin e Mbrojtjes Nurettin Canikli dhe zyrtarë të tjerë të lartë.

NATO është e rëndësishme për Turqinë dhe Turqia është e rëndësishme për NATO-n

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, gjatë vizitës së në Ankara, pas takimit me Ministrin e Punëve të Jashtme të Turqisë, Mevlüt Çavuşoğlu, dha një konferencë të përbashkët për shtyp.

Stoltenberg vlerësoi kontributet



e Turqisë në operacionet e NATO-s, duke përfshirë ato në Afganistan dhe në Kosovë, si dhe në luftën kundër ISIS. "NATO qëndron me ju në solidaritet," theksoi ai, duke vënë në dukje mënyrat në të cilat Aleanca kontribuon në sigurinë e Turqisë.

Kjo është hera e shtatë, që Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s viziton Turqinë dhe ai theksoi se nuk ka asnjë shtet tjetër që ka vizituar kaq shumë. "Është me të vërtetë mirë të kthehem këtu në Ankara dhe të them se kjo është vizita ime e shtatë në Ankara dhe nuk ka pothuajse asnjë vend tjetër që kam vizituar kaq shumë herë sa Turqinë. Faleminderit për mikpritjen dhe mirësinë tuaj të ngrohtë për mua dhe delegacionin tim. Ne patëm një takim shumë të mirë dhe një drekë të shkëlqyer ku kemi drejtuar një gamë të gjerë çështjesh të ndryshme."

Ai tha se "Vizitat e mia të shumta në Ankara pasqyrojnë rolin e thellë që luan vendi juaj në Aleancën e NATO-s. Turqia kontribuon në sigurinë tonë të përbashkët në shumë mënyra të ndry-

shme. Ju jeni një aleat që luan një rol kyç në Aleancë dhe ju falënderoj për kontributet tuaja të shumta. Ai tha se Turqia jep kontribut thelbësor për operacionet e NATO-s dhe për luftën kundër Daeshit. "Avionët tanë të mbikëqyrjes AWACS fluturojnë nga Konia në mbështetje të Koalicionit Global për të mposhtur Daesh", tha Stoltenberg

Turqia gjithashtu ndihmon për të ndërtuar stabilitet jashtë vendit, tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, "Duke luajtur një rol udhëheqës në Afganistan me qindra trupa në Misionin tonë Mbështetës të Përhershëm në Afganistan dhe Turqia gjithashtu ndihmon me financimin e ushtrisë kombëtare dhe të forcave të sigurisë afgane; Turqia po kontribuon në misionin e NATO-s në Kosovë; Dhe ju përkrahni aktivitetet tona të trajnimit në Irak. Pra, Turqia me të vërtetë bën shumë për Aleancën tonë, pavarësisht përballjes me sfida serioze të sigurisë."

Duke folur për sulmet terroriste në Turqi, Sekretari i Përgjithshëm i

NATO-s tha se "Asnjë aleat tjetër nuk ka vuajtur aq shumë sulme terroriste si Turqia dhe ju jeni aleati më i ekspozuar ndaj jostabilitetit në këtë rajon". Por ndërkohë, ai tha gjithashtu se Turqia bujare pret më shumë se 3 milion e gjysmë refugjatë. "Por ju nuk qëndroni të vetëm. NATO qëndron me ju në solidaritet. Garancia jonë e sigurisë në Nenin 5 është thelbi i Aleancës, një për të gjithë, dhe të gjitha për një."

Aleanca e NATO-s mbështet Turqinë me masa sigurie, duke përfshirë avionët e mbikëqyrjes AWACS, patrullat detare dhe ushtrimet. "Ne kemi vendosur sistemet e mbrojtjes nga ajri dhe raketat që nga viti 2013, duke ndihmuar në mbrojtjen e kufirit të Turqisë kundër kërcënimeve nga Siria. Kjo vendosje është zgjeruar edhe këtë vit, me kërkesë të Turqisë", tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s.

Lidhur me mbrojtjen e raketore të NATO-s Stoltenberg tha se "Ju jeni gjithashtu pjesë e sistemit të mbrojtjes raketore të NATO-s, me një radar thelbësor të bazuar këtu në Turqi. Komanda jonë Tokësore në Izmir është gjithashtu pjesë e pranisë së NATO-s në Turqi". Ai tha se për shumë vite, NATO ka siguruar miliarda në financim për infrastrukturën ushtarake në Turqi.

"Pra, NATO është e rëndësishme për Turqinë dhe Turqia është e rëndësishme për NATO dhe kjo është forca e Aleancës: 29 aleatë që qëndrojnë së bashku, duke mbrojtur njëra-tjetrën."

Duke folur për përgatitjet e samitit të NATO-s në korrik, Jens Stoltenberg tha se "Sot kemi pasur një diskutim të mirë në përgatitjet tona për Samitin e Brukselit të liderëve të NATO-s në korrik. Për shtatë dekada NATO ka qenë në gjendje të mbrojë qytetarët tanë, bazuar në vlerat tona: demokracia, sundimi i ligjit dhe liria individuale.

Që nga viti 2014, NATO ka zbatuar përforsimin më të madh të mbrojtjes tonë kolektive që nga fundi i Luftës së Ftohtë. Me më shumë forca në gatishmëri më të lartë. Mbrojtje më

të forta kibernetike dhe raketore. Dhe shpenzimet në rritje të mbrojtjes. Ne gjithashtu i dyfishuam përpjekjet tona për të luftuar terrorizmin. Përfshirë duke forcuar misionin tonë në Afganistan, me mbështetje të fuqishme nga Turqia. Dhe ne po rrisim mbështetjen tonë edhe për partnerët e tjerë.

Në samitin në korrik kemi në plan të nisim një mision trajnimi të NATO-s në Irak. Ndihamë e forcave lokale për të stabilizuar vendin e tyre dhe për të parandaluar kërcënimet terroriste ndërkombëtare si ISIS të kthehen. Unë mbështetem tek mbështetja e Turqisë për të nisur misionin dhe për kontributin e ardhshëm të Turqisë në mision", tha Stoltenberg

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s tha se "Ne gjithashtu diskutuam situatën në Siri. Ministri Çavuşoğlu më informoi për Operacionin Dega e Ullirit. Dhe unë jam mirënjohës për transparencën e vazhdueshme të Turqisë për këtë".

Sulmi me armë kimike në Douma ishte një temë tjetër diskutimi. "Këshilli i Atlantikut të Veriut u takua në fundjavë për t'u përditësuar për aksionin e përbashkët ushtarak të Aleancës së NATO-s Francë, MB dhe SHBA që të degradojë aftësitë e armëve kimike të regjimit sirian dhe të pengojë sulme të tilla të mëtejshme".

Stoltenberg tha se "NATO dënon ashpër përdorimin e vazhdueshëm të armëve kimike nga regjimi sirian, si një kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Ata që janë përgjegjës duhet të mbahen përgjegjës dhe ne duhet të bëjmë gjithçka që mundemi për të mbrojtur ndalimin ndërkombëtar për përdorimin e armëve kimike".

"Nuk ka zgjidhje ushtarake për këtë konflikt", tha Sekretari i Përgjithshëm. "Prandaj, NATO mbështet plotësisht përpjekjet e udhëhequra nga Kombet e Bashkuara për të arritur një zgjidhje të qëndrueshme politike për konfliktin në Siri", përfundoi Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg.

NATO mbështet sulmin kundër objekteve kimike në Siri

Deklaratë nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s mbi veprimet kundër objekteve dhe aftësive të armëve kimike të regjimit sirian

Unë mbështes veprimet e ndërmarra nga Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar dhe Franca kundër objekteve dhe aftësive të armëve kimike të regjimit sirian. Kjo do të zvogëlojë aftësinë e regjimit për të sulmuar më tej njerëzit e Sirisë me armë kimike. NATO ka dënuar vazhdimisht përdorimin e vazhdueshëm të armëve kimike nga Siria si një shkelje e qartë e normave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare. Përdorimi i armëve kimike është i papranueshëm dhe përgjegjësit duhet të mbahen përgjegjës. NATO e konsideron përdorimin e armëve kimike si një kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare dhe beson se është thelbësor për të mbrojtur Konventën e Armëve Kimike. Kjo kërkon një përgjigje kolektive dhe efektive nga bashkësia ndërkombëtare."

NATO dënon ashpër përdorimin e vazhdueshëm të armëve kimike nga regjimi sirian

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka mbajtur një konferencë për shtyp pas takimit të Këshillit të Atlantikut të Veriut mbi Sirinë. "Këshilli i Atlantikut të Veriut sapo është takuar. Franca, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara informuan aleatët për veprimin e tyre të përbashkët ushtarak në Siri brenda natës. Ata gjithashtu informuan mbi masat shtesë jo-ushtarake të marra për të përforcuar Konventën e Armëve Kimike. Të tre aleatët theksuan se një informacion i rëndësishëm tregonte se regjimi sirian

ishte përgjegjës për sulmin e tmerrshëm kundër civilëve në Douma më 7 prill e cila vrau një numër të madh të fëmijëve, grave dhe burrave. Ata gjithashtu bënë të qartë se veprimi i tyre ushtarak ishte i kufizuar në objektet e regjimit sirian që mundësonin prodhimin dhe aktivizimin e armëve kimike. Ata theksuan se nuk kishte asnjë alternativë praktike për përdorimin e forcës. Të gjithë aleatët e NATO-s shprehën mbështetjen e tyre të plotë për veprimet e natës së fundit. E cila kishte për qëllim të shkatërronte aftësinë e armëve kimike të regjimit sirian dhe për të penguar sulme të mëtejshme të armëve kimike kundër popullit të Sirisë. NATO dënon ashpër përdorimin e vazhdueshëm të armëve kimike nga regjimi sirian. Armët kimike nuk mund të përdoren pa u ndëshkuar. Ato nuk mund të normalizohen. Ata janë një rrezik i menjëhershëm për popullin sirian dhe për sigurinë tonë kolektive. Dhe ata që janë përgjegjës duhet të mbahen parasysht. Ne i bëjmë thirrje regjimit sirian dhe mbështetësve të tij, Rusisë dhe Iranit, që të lejojnë akses humanitar të shpejtë, të qëndrueshëm dhe të papenguar. NATO ka dënuar vazhdimisht përdorimin e vazhduar të armëve kimike nga Siria si një kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Veprime të tilla të egra kërkojnë një reagim kolektiv dhe efektiv nga ana e bashkësisë ndërkombëtare. Ne mbështesim mekanizmat ndërkombëtare për të vendosur përgjegjësinë dhe për të parandaluar mosndëshkimin në përdorimin e armëve kimike. Më vjen keq që mandati i Mekanizmit të Përbashkët Hetimor, për të identifikuar

autorët e sulmeve kimike, nuk u rinovua vitin e kaluar. Edhe pse u vendos me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara tre vjet më parë. Megjithë përpjekjet e vazhdueshme diplomatike, përdorimi i përsëritur i armëve kimike nga ana e regjimit sirian ndaj popullit të vet ka kontribuar në tmerrin e vuajtjeve njerëzore që nga fillimi i konfliktit. Përdorimi i armëve të tilla barbare është në shkelje flagrante të standardeve ndërkombëtare dhe normave ndërkombëtare. Ajo është në kundërshtim me rezolutat e shumta të Kombeve të Bashkuara dhe me Konventën e Armëve Kimike, të cilën Siria e ratifikoi në vitin 2013. Njëqind vjet pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, ne duhet të bëjmë gjithçka që mundemi për të mbështetur dhe jo për të shkatërruar Konventën e Armëve Kimike. NATO mbështet plotësisht përpjekjet e udhëhequra nga Kombet e Bashkuara për të arritur një zgjidhje të qëndrueshme politike për konfliktin në Siri. Ne u bëjmë thirrje të gjithë anëtarëve të Këshillit të Sigurimit të OKB-së që të mbajnë përgjegjësitë e tyre. Në të njëjtën kohë, u bëjmë thirrje të gjithë mbështetësve të regjimit sirian, veçanërisht Rusisë, që të ushtrojnë përgjegjësi për të siguruar që regjimi sirian të marrë pjesë në mënyrë konstruktive në procesin e Gjenevës të udhëhequr nga OKB. NATO mbetet e përkushtuar ndaj Koalicionit për të Mposhtur ISIS, koalicion në të cilin ne jemi pjesë. Humbja e terrorizmit në të gjitha format e tij mbetet një objektivi kyç për vendet tona dhe një sfidë kryesore për stabilitetin në rajon."

MSC. MIMOZA GOLIKJA

ROSE GOTTEMOELLER NË UKRAINË

Gottemoller: Mjegulla e luftës është errësuar

Nënsekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Rose Gottemoeller, në Forumin e Sigurisë së Kievit, në Ukrainë

Nënsekretari i Përgjithshëm i NATO-s Rose Gottemoeller nënvizoi mbështetjen e fortë të Aleancës për Ukrainën gjatë një vizite dy-ditore në Kiev, më 12 dhe 13 prill 2018. Duke ju drejtuar Forumit të Sigurisë në Kiev, Gottemoeller përshëndeti përparimin e Ukrainës në axhendën e reformave dhe theksoi rëndësinë e shkëmbimit të përvojave dhe praktikave më të mira në zhvillimin e luftës hibride. Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm shpjegoi hapat që NATO po merr për të parandaluar dhe mbrojtur më mirë nga kërcënimet hibride ose asimetrike. “Duhet të jemi më të vetëdijshëm dhe të vëmendshëm, duhet të jemi të durueshëm ndaj sulmeve dhe ne duhet të jemi të gatshëm të përgjigjemi”, tha ajo. Gottemoeller gjithashtu adresoi përpjekjet e Rusisë për të minuar ligjin ndërkombëtar dhe përshëndeti solidaritetin e Ukrainës me aleatët e NATO-s në përgjigje ndaj sulmit të Salisbury. Gjatë vizitës së saj në Kiev, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm u takua me zëvendës kryeministrin për Integrimin Europian dhe Euro-Atlantik Ivanna Klympush-Tsintsadze, ministrin e Arsimit dhe Shkencës Lilia Hrynevych, zëvendës ministrin e Mbrojtjes, Anatolij Petrenko dhe zyrtarë të tjerë të lartë. Ajo gjithashtu u takua me ministrin e jashtëm Pavlo Klimkin dhe zëvendës shefin e administratës presidenciale Kostyantyn Yeliseyev.

Ukraina stabilitet në mjedis serioz pune

Duke ju drejtuar Forumit të Sigurisë së Kievit, në Ukrainë Zëvendës Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s, Rose Gottemoeller tha se ishte e kënaqur që “jam kthyer në këtë podium”. Ajo kujtoi këtë ditë, pikërisht një vit më parë, kur Ukraina mori lajmin e mirë të regjimit të vizave për banorët e saj. “Më kujtohet mirë kur isha këtu vitin e kaluar për këtë konferencë dhe dita”, tha ajo, “ditën kur isha këtu u njoftua regjimi pa viza për Ukrainën. Ishte një ditë shumë emocionuese, një seancë shumë emocionuese, dhe kjo është një konferencë shumë emocionuese” tha Gottemoeller duke duke falenderuar për ftesën. “Është një nder tha ajo jo vetëm për të qenë këtu, por dhe të kesh një mundësi për të folur me ju. “Për shkak se ka pasur shumë progres drejt reformës në vitin e kaluar. Doja të nëvizoj ndërsa nis fjalën time, në lidhje me ligjin për sigurinë kombëtare që ka kaluar leximin e parë tani dhe ky është një hap shumë i rëndësishëm. Natyrisht, ne shpresojmë në NATO, që të gjitha parimet themelore, parimet dhe ideat e rëndësishme që janë kaq të rëndësishme për rrugën demokratike të Ukrainës do të përfshihen në versionin përfundimtar”.

Rose Gottemoeller tha se përtej atij projektligji, që është vërtet, pjesë e punës bazë të NATO-s, “ekspertët tanë janë duke punuar me ekspertët tuaj, por përtej arenës kombëtare të sigurisë dhe mbrojtjes, reformat po përparojnë gjithashtu në fusha të tjera të rëndësishme; shëndetësia, edukimi, mirëqenia e popullit ukrainas, dhe është mbresëlënëse për mua që të kem një mundësi për të arritur këtë, ndërsa unë jam këtu në Kiev”.

Duke krahasuar me një vit më parë që nga viti i kaluar tha ajo “ka pasur një stabilitet të tillë për një mjedis serioz të punës këtu në Kiev dhe me të vërtetë shpresoj, nga ku unë qëndroj, se do të vazhdojnë mundësitë për të ecur përpara në të gjithë Agjendën e reformave. Është shumë e rëndësishme të vazhdojmë procesin serioz të punës”, nënvizoi Gottemoeller.

“Por këtu këtë mëngjes, theksi ynë është të flasim për mjegullën e luftës dhe paqen. Dhe me të vërtetë thënia e



vjetër e Clausewitz për mjegullën e luftës është errësuar, për shkak të përdorimit të hibridit nga Rusia, ose siç i quajmë ndonjëherë, teknika asimetrike. Kjo ka krijuar një mjegull as të paqes, as të luftës, por të krizës dhe destabilizimit të vazhdueshëm dhe në Donbass, trishtim, konflikt të nxehtë. Sulmet kibernetike, dezinformimi, ndërhyrjet në zgjedhje, përdorimi i agjentëve nervorë ... çdo ditë, këto rreziqe na ballafaqohen tani, me qëllim të mbjelljes së përçarjes dhe thyerjes së vendosmërisë sonë”. Ajo tha se “Askush nuk e di këtë më mirë se Ukraina, e cila po lufton këto teknika pa ndërprerje për katër vitet e fundit. E di që Ukraina ka mësuar shumë për mënyrën se si të luftohet. Një ekspert më tha mbrëmë se Ukraina tani është pak a shumë e vaksinuar kundër dezinformimit, e përgatitur me anti-trupat e duhura për të luftuar. Unë mendoj se ishte një koment shumë i rëndësishëm dhe desha të them se sa NATO po pret për të mësuar nga përvoja juaj. Ne kemi qenë shumë të lumtur që vitin e kaluar është formuar platforma e përbashkët e luftës hibride NATO-Ukrainë, kjo është një platformë që është e fokusuar në zhvillimin e luftës hibride. Dhe është me të vërtetë një element i rëndësishëm se si NATO mund të mësojë nga përvoja juaj dhe të mësojë nga praktikat më të mira që keni vënë në vend”.

Mbrojtja nga kërcënimet hibride ose asimetrike, disinformimi

“Një pyetje thelbësore për ne për të diskutuar këtë mëngjes është ajo që mund të bëjmë për të penguar dhe mbrojtur nga kërcënimet hibride ose asimetrike. Përgjigja kryesore që unë mendoj se qëndron në këtë drejtim: duhet të jemi më të vetëdijshëm dhe të vëmendshëm; ne duhet të jemi të qëndrueshëm ndaj sulmeve; ne duhet të jemi të gatshëm të përgjigjemi, ndoshta asimetrikisht”. Rose Gottemoeller solli disa shembuj, si krijimin e qendrës së përqendruar të kërcënimet hibride, “për

të zbuluar atë për të cilën po flas” tha ajo. “Më lejoni të ju jap disa shembuj, vetëm për të zbuluar atë për të cilën po flas. Para së gjithash, duhet të jemi më të vetëdijshëm dhe të vëmendshëm; Rose Gottemoeller tha se NATO ka bërë shumë për të reformuar organizatën tonë të inteligjencës gjatë viteve të fundit dhe një nga hapat kyç që kemi marrë është të formojmë një qendër që është e përqendruar në kërcënimet hibride. Duke punuar shumë ngushtë me BE-në, nga rruga, e cila gjithashtu ka vënë në vend një qendër të tillë. Kjo është shumë, shumë e rëndësishme, të kemi atë rrjedhë të informacionit të inteligjencës dhe të kemi ndarjen e informacioneve. Ne e vlerësojmë punën që Ukraina ka bërë për të ndarë me ne zbulimin dhe ne me të vërtetë kemi përfituar nga kjo”. Kjo është e rëndësishme tha ajo pasi “Është duke ndërtuar një vetëdije të përbashkët për atë se çfarë janë këto kërcënimet, çfarë mund të thonë, si mund të zhvillohen dhe si mund të evoluojnë. E gjithë kjo është shumë e rëndësishme”.

Përveç kësaj, “ne jemi duke menduar të përdorim më mirë burimet e hapura, vëzhgimin ndaj modeleve në media, duke përfshirë mediat sociale. Dhe këto modele, siç i njohim dhe i kuptojmë, tashmë po japin fryte në mënyrën se si reagojmë. Unë do të vjedh ... Shpresoj që ministri i Mbrojtjes i Lituanië nuk do të më pengojë të vjedh një shembull nga përvoja e Lituanië. Ju e mbani mend gjithë situatën me Lisin në Gjermani, dy vera më parë, kur pati histori për një vajzë të re me origjinë ruse, të përdhunuar nga emigrantët në Gjermani, emigrantë muslimanë. Papritmas kjo histori e njëjtë, e cila në fund nuk kishte asnjë të vërtetë për të, nuk u vërtetua se kishte të vërtetë, por me të vërtetë, në fakt kishte shumë vështirësi në Gjermani. Papritmas kjo histori, ose një version i saj, u shfaq në Lituani, me një vajzë të re duke u sulmuar nga trupat hyrëse gjermane, duke shërbyer në grupin e

betejës. Dhe ishte shumë interesante që mediat lituaneze menjëherë thanë, pritni një minutë, kjo është pjesë e një modeli, ne e pranojmë se diçka nuk është e drejtë këtu. Menjëherë investiguan në të dhe ishin në gjendje të zbulonin se nuk kishte asnjë të vërtetë për këtë çështje. Pra, kjo është vetëm një pikë që unë dua të bëj, dhe është për të gjithë miqtë tanë të shtypit rreth dhomës, edhe juve, Jens Stoltenberg pëlqen ta bëjë këtë pikë shumë, edhe juve ju duhet të shikoni në mënyrë kritike në këto tregime dhe të përpiqesh të gërmosh thellë, nëse ka diçka në modelin e tregimit që nuk duket e drejtë. Ne duhet të luftojmë aktivisht kundër dezinformimit dhe propagandës”.


Menaxhimi i krizës

Një fushë tjetër “ku mendoj se mund të vazhdojmë të punojmë me sukses së bashku është menaxhimi i krizës. Ne kemi nevojë për të vendosur procedura, atëherë ne duhet t'i ushtrojmë rregullisht ato, kështu që ne mund ta kuptojmë se sa mirë është vendimmarrja jonë dhe ne mund të dallojmë se ku ka boshllëqe. Ne kemi pasur disa procedura shumë të mira të menaxhimit të krizave të zhvilluara gjatë viteve të fundit. Ne jemi të gatshëm t'i ndajmë këto me partnerët. Ne jemi duke punuar për t'i ndarë ato tashmë me Ukrainën dhe trajnimi dhe ushtrimi së bashku me ju do të jetë shumë i rëndësishëm”. Një pjesë tjetër e krizave administruese ka qenë për të shkëmbyer informacion dhe “ne kemi qenë të kënaqur me shkallën në të cilën vendet e Aleancës, por edhe partnerët, kanë qenë të gatshëm të ndajnë informacione rreth krizave ndërsa ato zhvillohen, ashtu si në disa javët e fundit Britania e Madhe ka rregullisht informacione shumë serioze dhe shumë të hollësishme rreth rastit Skripal”. Pra, “shkëmbimi i informacionit, konsultimi, menaxhimi i krizave, të gjitha janë pjesë e së njëjtës fotografie”.

Lidhur me elasticitetin tha ajo “unë

nuk mund të flas më seriozisht për këtë çështje në sferën kibernetike, për të mbrojtur kundër sulmeve, sigurinë e energjisë; për të detyruar kthimin prapa mbizotërimit e një aktori të vetëm, si Gazprom, dhe, sado të them, përgjigja e CBRN, kimike, biologjike, radiologjike, bërthamore. Ne duhet t'i kushtojmë vëmendje çështjes së qëndrueshmërisë së CBRN-së këto ditë dhe mendoj se kjo është gjithashtu një fushë e rëndësishme ku partnerët tanë, si dhe aleatët, mund të bëjnë një ndryshim të rëndësishëm, sepse në mënyrë të qartë Ukraina ka shumë përvojë në CBRN elasticiteti”. Pra, është “një fushë shumë e rëndësishme për të punuar, por nuk jam e lumtur, pasi të gjitha këto vite luftojnë kundër armëve të shkatërrimit në masë në shumë mënyra, të gjithë ne po punojmë për të zvogëluar dhe eliminuar armët kimike, armët biologjike, kërcënimet nukleare dhe radiologjike, se ne duhet të jemi të shqetësuar përsëri për elasticitetin e CBRN”. Por kjo “është një pikë që dëshiroja të theksoja me të vërtetë për ju”, se “një nga aspektet e mëdha negative të asaj që Rusia ka bërë në vitet e fundit është ky sulm ndaj sundimit të së drejtës ndërkombëtare dhe regjimeve dhe traktateve të rëndësishme ndërkombëtare” që kanë parashikuar shumë parashikueshmëri, dhe gjithashtu për zvogëlimin dhe eliminimin e armëve të shkatërrimit në masë. “Pra, kjo është një çështje jashtëzakonisht serioze”.

Duke përfunduar Rose Gottemoeller tha se “mendoj se duhet të jemi të gatshëm të përgjigjemi dhe ndoshta ta bëjmë këtë në mënyrë asimetrike. Pra, kur mbaroj, desha vetëm të bëja një vërejtje dhe kjo është të shprehim mirënjohjen dhe mirënjohjen tonë që Ukraina u bashkua me të gjithë aleatët dhe shumë nga partnerët tanë, në përgjigje që Britania e Madhe na kërkoi të zhvillonim lidhur me helmimin e Sergei Skripal dhe vajzës së tij, me një agjent nervash. Prandaj, kur Ukraina vendosi të dëbonte 13 rusë nga përfaqësimi këtu, ajo u bashkua me shumë aleatë dhe me vetë institucionin e NATO-s. Ne hoqëm akreditimin e disa rusëve, shtatë vende, ata që ishin në Misionin në NATO dhe Sekretari vendosi të mos zgjasë akreditimin për tre të tjerë që e kishin kërkuar atë. Pra, një total prej dhjetë diplomatësh rusë nuk përfunduan, ose duke mos qenë në gjendje të vijnë në NATO ose të largohen nga Brukseli dhe të largohen nga selia jonë”. Ajo tha se NATO ka ndërmarrë hapa “për të ulur numrin me dhjetë nga numëri i atyre në Misionin Rus në NATO. Pra, të gjithë ne kemi ndërmarrë hapa të tillë. Ne e vlerësojmë me të vërtetë solidaritetin e Ukrainës dhe punojmë së bashku me ne. Është se uniteti i përgjigjes që mendoj se ka bërë një përshtypje në Kremlin, ka bërë një përshtypje në Moskë. Por këto janë të gjitha hapat që mendoj se ne duhet të vazhdojmë të mendojmë se si të zhvillohet në mënyrë vendimtare, ndërsa shkojmë përpara.”



Komandanti i FSK-së gjeneral lejtant Rrahman Rama në fjalën e tij e njoftoi delegacionin e lartë nga Brukseli, me aktivitetet në FSK si; për sukseset e kadetëve në vendet e ndryshme të botës; për sukseset e FSK-së në fushat operacionale; nivelin e stërvitjeve me standarde të NATO-s; pjesëmarrjen e FSK-së në trajnime dhe ushtrime fushore ndërkombëtare...



Delegacioni i NATO-s në Kosovë

Transformimi i FSK-së të bëhet mbi baza kushtetuese

Ministri i FSK-së Rrustem Berisha së bashku me komandantin e FSK-së gjenerallejtant Rrahman Rama, të shoqëruar nga zyrtarët dhe eprorë të lartë të ministrisë dhe FSK-së, pritën më 13 prill 2018, një delegacion të lartë të NATO-s të kryesuar nga zoti John Manza zëvendës asistent i Sekretarit Gjeneral të NATO-s, i cili shoqërohej në takim edhe me zëvendës shefi i Ekipit Këshillues Ndërlidhës të NATO-s (NALT) zoti Mark Theobald. Ministri Berisha ka vlerësuar lartë shkallën e bashkëpunimit të deri tashëm me NATO-n si dhe ka falënderuar për kontributin e NALT-it në MFSK dhe FSK si dhe bashkëpunimin e mirë me KFOR-in. Ai ka theksuar bashkëpunimin e mirë me shtet fqinjë, posaçërisht me ato shtete që kemi të nënshkruar marrëveshje bilaterale bashkëpunimi. Me këtë rast ai ka folur edhe për suksesin e integritet të komuniteteve pakicë në FSK, posaçërisht të komunitetit serb. Ministri Berisha ka kërkuar që të ketë përkrahjen e NATO-s për anëtarësim të Kosovës në nismat regionale të Sigurisë. Më tej ministri Berisha ka folur edhe për përgatitjet që janë bërë në procesin e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura, por duke qenë të përkushtuar që gjithçka të jetë e koordinuar me partnerët strategjik.

Komandanti i FSK-së gjenerallejtant Rrahman Rama në fjalën e tij e njoftoi delegacionin e lartë nga Brukseli, me aktivitetet në FSK si; për sukseset e kadetëve në vendet e ndryshme të botës; për sukseset e FSK-së në fushat operacionale; nivelin e stërvitjeve me standarde të NATO-s; pjesëmarrjen e FSK-së në trajnime dhe ushtrime fushore ndërkombëtare; për përgatitjet për konferencën vjetore të prillit "FSK dhe partnerët"; për përgatitjet për mbajtjen e ushtrimit fushor "Shqiponja -6", ku



do jenë pjesëmarrëse edhe 12 shtete partnere të Kosovës. Në fjalën e tij theksoi se FSK ka bërë të gjitha përgatitjet dhe planet për transformimin e FSK-së dhe pret vendimin politik. Si prioritet komandanti i FSK-së shtroi kërkesën që FSK-ja të jetë ofruar i sigurisë përmes Operacioneve të Mbështetjes së Paqes. Nga ana e tij zëvendës asistenti i Sekretarit Gjeneral të NATO-s zoti John Manza u shpreh i kënaqur nga arritjet e FSK-së, duke vlerësuar se, si institucion i ri keni ecur

shumë përpara. Ju keni bërë gjithçka në mënyrën e duhur. Si FSK jeni të përfaqësuar shumë lartë nga performanca e kadetëve tuaj në akademitë ushtarake jashtë vendit. Keni bërë punë të shkëlqyer me integrimin e komuniteteve pakicë. Ndryshimet për transformimin e FSK-së duhet të bëhen mbi bazën kushtetuese. Të jeni të fokusuar dhe përqendruar në arritjen e synimeve afatgjata. Dy delegacionet u pajtuan që bashkëpunimi Kosovë - NATO, duhet të thellohet në fushat ku ekziston mundësia.

BASHKËPUNIMI "NATO-KOSOVË"

"Struktura ligjore e NATO-s dhe Partneriteti"

Në kuadër të zgjerimit të bashkëpunimit "NATO-Kosovë" është zhvilluar më 14 prill seminari me temën: "Struktura ligjore e NATO-s dhe Partneriteti". Drejtuar dhe organizuar nga NATO, në bashkëpunim me Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, nga data 11-13 prill, në hotelin Emerald, u mbajt seminari, Struktura ligjore e NATO-s dhe Partneriteti, në të cilin morën pjesë zyrtarë të lartë të Ministrisë së FSK-së dhe stafit të lartë të FSK-së, si dhe përfaqësues të institucioneve të Qeverisë së Republikës të Kosovës. Qëllimi kryesor i seminarit ishte njohja e strukturave të funksionimit të NATO-s, si dhe misionet e saj. Drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane në Ministrinë për FSK-në, z. Faruk Geci, njëherësh edhe koordinator i seminarit, tha se: "Seminare të tilla do të zhvillohen gjatë tërë vitit, me qëllim dhe synim njohjen sa më të mirë të funksionimit të NATO-s".



DITA NDËRKOMBËTARE E RREZIKUT NGA MINAT

Që nga viti 1999 në Kosovë janë asgjësuar 88,895 mina

Që nga viti 1999 në Kosovë janë pastruar 51,216,184 metra katrorë dhe janë asgjësuar 88,895 mina dhe mjete eksplozive të pashpërthyer. Nga minat dhe mjetet tjera të pashpërthyer kanë humbur jetën 117 qytetarë si dhe kanë marrë lëndime të rënda 463 veta.

Forca e Sigurisë së Kosovës së bashku me organizatat ndërkombëtare për deminim që veprojnë në Kosovë shënuan 4 Prillin-Ditën Ndërkombëtare të vetëdijesimit të rrezikut nga minat dhe mjetet e tjera të pashpërthyer. Në shënimin e kësaj dite morën pjesë Shkolla ndërkombëtare e eliminimit të mjeteve të pashpërthyer (EOD) në Kosovë, MAT Kosova, HALO Trust dhe NPA. Shënimi i kësaj dite u organizua dje në Pejë.

Zoti Sallova foli edhe për sukseset e ekipeve të deminimit të FSK-së dhe bashkëpunimin me organizatat



tjera ndërkombëtare si: HALO Trust dhe NPA, të cilat janë duke krijuar një mjedis të sigurt në fushat e rrezikuara, duke mundësuar zhvillimin e jetës normale në Kosovë. "Këto rezultate na bëjnë krenarë për punën e shkëlqyer që është duke u bërë nga ekipet e deminimit të FSK-së. Falë punës së tyre, janë shpëtuar shumë jetë njerëzish dhe

njëkohësisht është kthyer një numër i madh i tokave komuniteteve të ndryshme për shfrytëzimin e tyre. Edhe përkundër pastrimit të shumë fushave të rrezikshme të minuara në Kosovë kanë mbetur edhe 98 zona të afektuara nga minat apo bombat kasetore".


Zotëri Sallova vazhdoi fjalën e tij duke i shpalosur disa tregues të rezultateve: "Prej fillimit të operacioneve të deminimit, pra që nga viti 1999, janë pastruar 51,216, 184 metra katrorë dhe janë gjetur dhe asgjësuar 88,895 mina dhe mjete eksplozive të pashpërthyer. Me gjithë këto rezultate nuk duhet të harrojmë faktin se që nga koha e luftës e deri më sot, 117 persona kanë humbur jetën si pasojë e minave dhe mjetet tjera eksplozive dhe 463 veta kanë marrë lëndime të rënda trupore". Në fund u bë edhe prezantimi i pajisjeve të deminimit dhe të arriturave të përgjithshme të organizatave pjesëmarrëse në Kosovë.

"Dita e shqipes" në Koshare

Ministri Berisha: Të ruajmë kujtesën historike duke respektuar vlerat madhore, të cilat janë në themelet e këtij shteti

Më 9 prill u organizua manifestimi "Ditët e shqipes" nën patronatin e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj. Në këtë manifestim morën pjesë mijëra qytetarë nga të gjitha trojet shqiptare, si dhe kryetari i Kosovës Hashim Thaçi dhe kryeministri i Kosovës, z. Ramush Haradinaj. Fillimisht ministri Berisha dhe gjenerallejtant Rrahman Rama, bënë homazhe në varrezat e dëshmorëve të Kompleksit Memorial në Koshare, si dhe takuan familjarët e dëshmorëve, të cilëve, gjatë bisedës u shprehën mirënjohje për veprën sublimë të dëshmorëve të rënë në altarin e lirisë.

Ministri i FSK Rrustem Berisha në kuadër të manifestimit mbajti fjalën e tij si ish-komandant i "Brigadës 138-Agim Ramadani" të UÇK-së, duke ju drejtuar pjesëmarrësve të manifestimit tha: "Jemi mbledhur këtu, sikur çdo vit, më 9 prill, për të kujtuar të rënë e gjallë, të cilët me pushkë në dorë e bënë atë që gjenerata të kësaj toke kishin pritur për gati një shekull". "Agimi, Salihu, Xhemajli, Abazi, Aliu e 109 shokët e pushkës të cilët prehen në këtë lëndinë e kanë dhënë maksimumin në jetën e kësaj bote, para se të shkojnë në amshim" kështu i përkujtoi bashkëluftëtarët, z. Berisha. Duke folur për Betejën e Koshares, ministri Berisha tha: "Këtu u luftua nga Rrasa e Zogut e deri në Morinë, nga Bjeshkët e Padeshit e deri te livadhi i Shabanit, e më tutje. Këtu u luftua ditë për ditë, në borë e shi, e në breshërinë e plumbave e predhave të armikut". Ministri Berisha, në fund, duke iu drejtuar të pranishmëve tha se: "Jam krenar për të gjithë ata djem dhe vasha, që me kontributin e tyre kolosal ishin thelbi i suksesit të Betejës së Koshares". "Jam krenar që patëm mbështetjen e Malësisë së Gjakovës. Secili luftëtar i Betejës së Koshares, do të jetë falënderues përgjithmonë për këtë. Unë dhe gjithë bashkëluftëtarët e mi, jemi krenar që këtu, patëm mbështetjen e gjithë kombit tonë. Luftës sonë iu bashkuan pushkët nga të gjitha trojet shqiptare. Ne jemi krenar që, Kosharja u bë pikë bashkimi dhe burim i forcës, për gjithë UÇK-në".



Qëllimi i vizitës është për të diskutuar mbi mundësitë për të rritur bashkëpunimin ushtarak dypalësh midis dy ushtrive, si dhe në kuadër të Kartës SHBA-Adriatik (A-5). Takimi në nivel të shefave të shtabeve u fokusua kryesisht në mundësitë e rritjes së nivelit të kryerjes së trajnimit të përbashkët ushtarak përmes përdorimit të kapaciteteve të dy ushtrive.



Gjeneral lejtnant Metodi Veliçkovski në Kroaci

Bashkëpunim dypalësh në kuadër të Kartës SHBA-Adriatik (A-5)

Delegacioni i ARM-së i kryesuar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral lejtnant Metodi Veliçkovski nga 11 deri më 13 prill, zhvilloi një vizitë në Forcat e Armatosura (FA) të Republikës së Kroacisë, ku u takua me homologun e tij, shefin e Shtabit të Forcat e Armatosura Kroate, Gjenerali Mirko Shundov.

Qëllimi i vizitës është për të diskutuar mbi mundësitë për të rritur bashkëpunimin ushtarak dypalësh midis dy ushtrive, si dhe në kuadër të Kartës SHBA-Adriatik (A-5). Takimi në nivel të shefave të shtabeve u fokusua kryesisht në mundësitë e rritjes së nivelit të kryerjes së trajnimit të përbashkët ushtarak përmes përdorimit të kapaciteteve të dy ushtrive. Delegacioni i ARM-së zhvilloi një takim në Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë.

Gjeneral Veliçkovski gjatë bisedimeve theksoi rëndësinë e sigurisë së përgjithshme në rajon duke plotësuar pranimin në NATO të vendeve të A5. Ndër të tjera Veliçkovski ka folur për format e reja të sfidave të sigurisë të paraqitura në formë radikalizuese, por edhe për sulmet kibernetike ekstreme, ku Republika e Maqedonisë mbetet e angazhuar plotësisht për krijimin e kapaciteteve të përbashkëta në mbrojtjen e vendit. Gjatë vizitës tre-ditore delegacioni ushtarak i Maqedonisë ka zhvilluar vizita në Komandën e Forcave Speciale të Forcave të Armatosura të Republikës Kroacisë në Delnec dhe në Shkollën e Lartë Ushtarake “Dr.



Franjo Tuxhman”. Delegacioni maqedonas përbëhej nga komandantët e Komandës Speciale të Regjimentit për operacione dhe Komanda e Trajnimit dhe Doktrinës, ku janë takuar me komandantët e qendrave dhe njësitëve dhe kanë vizituar pjesëtarët e armatës maqedonase të cilët janë për arsimim në shkollën ushtarake në Kroaci.

Armata e Maqedonisë ka një bashkëpunim ushtarak dypalësh shumë të mirë me Forcat e Armatosura të Republikës së Kroacisë, si me kryerjen e studimeve në shkollat ushtarake kroate të ushtarakëve maqedonas, por edhe në realizimin e stërvitjeve të përbashkëta, si dhe në kuadër të Kartës SHBA-Adriatik (A-5).

EKSPERTËT GJERMANË NË SHKUP

Gjermanët asistojnë reformën në Ministrinë e Mbrojtjes

Sekretari i Shtetit në Ministrinë e Mbrojtjes, Dragan Nikoliq u takua më 11 prill, me një ekip ekspertësh për planifikim strategjik nga Ministria e Mbrojtjes së Republikës Federale të Gjermanisë, i cili qëndron për vizitë në Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë.

Rishikimi i ri Strategjik i Mbrojtjes dhe Strategjia e re e Mbrojtjes janë dy segmente kyçe të procesit të reformave të iniciuara nga udhëheqja e re e MM. “Ne jemi tani në fazën vendimtare të përgatitjes së dokumenteve”, tha sekretari i shtetit Nikoliq në takim. Ai falënderoi për mbështetjen e Gjermanisë dhe theksoi se Ministria është fort e përkushtuar në zbatimin e reformave që kanë për qëllim përmirësimin e standardit të jetesës dhe punës së secilit pjesëtar të ARM-së dhe për arritjen e qëllimit strategjik të Republikës së Maqedonisë – anëtarësimi në NATO. Ekipi i ekspertëve ndodhet në Maqedoni për të përcaktuar proceset e reformës në Ministrinë e Mbrojtjes dhe të Armatës së Republikës së Maqedonisë, si dhe për të zbuluar segmente në të cilat Ministria e Mbrojtjes e Republikës Federale të Gjermanisë mund të mbështesë zbatimin e këtyre reformave. Mbështetja e RF të Gjermanisë pritet edhe në procesin e zbatimit të Shqyrtimit Strategjik të Mbrojtjes.

Gjatë vizitës, ekspertët gjermanë gjithashtu u takuan me të gjithë personat relevant të përfshirë në proceset e reformës në Ministri, Grupin kryesor koordinues për Shqyrtimin Strategjik të Mbrojtjes, autoritetet e politikës dhe planifikimit dhe përfaqësuesit e Shtabit të Përgjithshëm të Armatës.

25 VJET PROGRAM BASHKËPUNIMI

Kryekomandanti Gardës Kombëtare të Vermontit në ARM

Si pjesë e aktiviteteve të planifikuara në mes Armatës së Maqedonisë dhe Gardës Kombëtare (NG) Vermont, një grup ushtarakësh amerikanë kanë vizituar ARM-në. Vizita ishte pjesë e aktiviteteve të planifikuara nga ana e Gardës kombëtare të Vermontit që shënon 25 vjet nga themelimi i programit të bashkëpunimit, ku në vitin 1993 filloi programi i parë amerikan për të mbështetur dhe zhvilluar Republikën e pavarur të Maqedonisë.

Me nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit në vitin 1994 u formalizua bashkëpunimi përmes formave të ndryshme të arsimit dhe trajnimit me Gardën Kombëtare të Vermontit ku deri tani janë trajnuar mbi 4000 anëtarë të ushtrisë maqedonase, të cilët patën mundësi të njihen me standartet, taktikat dhe teknikat që veprojnë në Gardën Kombëtare. ARM ka marrë pjesë në Task Force “Phoenix”, “Misionin ISAF në Afganistan”, kur pjesëtarët të ushtrisë kanë qënë së bashku me anëtarët e Gardës kombëtare të Vermontit. Përfaqësues të Gardës Kombëtare të Vermontit, kanë dhënë një leksion në vitin e katërt të Kolegji Ushtarak dhe kanë zhvilluar vizita në njësitë ushtarake.



KAPITEN GORAZD BARTOL

Maqedonia ka mundësi të bëhet anëtar i 30-të i NATO-s

Në hotelin “Holiday Inn” për disa ditë, mbështetur nga programi i NATO-s për paqen dhe sigurinë, u zhvillua konferenca për mbrojtjen kundër terrorizmit dhe forcimin e institucioneve demokratike dhe sundimin e ligjit.

Ky aktivitet u drejtua nga zëvendës ministri i Mbrojtjes, Bekim Maksuti i cili para të pranishmivi foli mbi skemat e sigurisë kundër kërcënimeve të reja. Ai theksoi se sfidat e sotme të sigurisë nuk janë vetëm kërcënim për një shtet të caktuar apo individët, por kundër një sistemi të përbashkët të vlerave dhe se krijimi i skemave është një model i shkëlqyer për krijimin e një sistemi për përgjigje ndaj tyre. Maksuti shtoi se Maqedonia edhe pse nuk është anëtar e NATO-s monitoron nga afër tendencat dhe rekomandimet e NATO-s në kontekst të përbashkët me terrorizmin kibernetik dhe për këtë qëllim është duke u punuar në një strategji për sigurinë kibernetike nga MM MPB dhe MSHIA, që do të duhet të jap nevojat prioritare për ngritjen e kapaciteteve. Në këtë kontekst, Maksuti tha se Akademia Ushtarake në shtator të këtij viti do të fillojë me një program të ri studimi, sigurinë kibernetike dhe forenzikën digjitale dhe me këtë do të kontribuojë



në zhvillimin e kapaciteteve shtetërore.

Gjatë referimit të tijm shefi i Zyrës Ndërlidhëse të NATO-s në Shkup, kapetan marine Gorazd Bartol u ndal në krenmtimin e 69 vjetorit të Aleancës së Atlantikut të Veriut, e cila, tha ai, angazhohet për të mbrojtur lirinë, trashëgiminë e përbashkët dhe qytetërimin popujve të vet, bazuar në parimet e demokracisë, lirisë personale dhe sundimit të ligjit. Ai i para të pranishmive shtoi se ishte i kënaqur që Maqedonia ka një mundësi unike në fund të bëhet anëtar i 30 i Aleancës së NATO-s dhe se NATO do të vazhdojë të mbështesë rrugën e reformave.



Kryetari i komunës së Podgoricës, Sllavoljub Stijepović tha se anëtarësimi në NATO nënkupton pajtueshmëri me kërkesat e caktuara të sigurisë dhe standardeve, dhe se do të mbështesë Ministrinë e Mbrojtjes. “Komuna e Podgoricës do të jetë bashkëpunuese dhe operacionale në kuptim të ligjit të obligimeve të parashikuara.



Kazermat “Masline” - qendra e ardhshme e forcave malazeze

Ministri i Mbrojtjes i Malit të Zi, z.Predrag Boskovic dhe kryetari i komunës së Podgoricës, Sllavoljub Stijepović vizituan më 11 prill kazermën “Masline”, ku në perspektivë do vendosen të gjitha institucionet e sistemit të mbrojtjes të Malit të Zi, por të forcave të sigurisë malazeze.

Boskovic tha se kazermat e Podgoricës janë rreth 350 mijë metra katrorë, ku cilën dikur janë stacionuar rreth 6000 ushtarë të APJ-së të zonës.

Fondet do të sigurohen nga buxheti i rregullt i Ministrisë së Mbrojtjes, ndërsa vendimi për përdorimin e ndërtesës në të cilën janë vendosur tani Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm, do ti kalojë institucionit të Administrimit të Pronës dhe Ministrisë së Financave.

Kryetari i komunës së Podgoricës, Sllavoljub Stijepović tha se anëtarësimi në NATO nënkupton pajtueshmëri me kërkesat e caktuara të sigurisë dhe standardeve, dhe se do të mbështesë Ministrinë e Mbrojtjes. “Komuna e Podgoricës do të jetë bashkëpunuese dhe operacionale në kuptim të ligjit të obligimeve të parashikuara. Prioriteti ynë është që ta zbatojmë këtë projekt

Anëtarësimi në NATO nënkupton standarde sigurie



sa më parë që të jetë e mundur,” tha Stijepovic. Ministri Bošković dhe Shefi i Shtabit të Ushtrisë së Malit të Zi, gjeneral brigade Ilija Daković, diskutuar më

parë me anëtarët e njëjësive të Ushtrisë së Malit të Zi, të cilat janë të vendosura në Batalionin e Logjistikës dhe kompaninë e Policisë Ushtarake.

PREDRAG BOSKOVIC NË DANILOVGRAD

Do ndërtohen 68 apartamente për Armatën e Malit të Zi

Ministri i Mbrojtjes i Malit të Zi, z.Predrag Boskovic dhe Kryetari i Danilovgradit, z.Branislav Djuranovic kanë vizituan vendndodhjen ku kanë filluar përgatitjet për ndërtimin e 68 apartamenteve për nevojat e Ushtrisë së Malit të Zi. Ministri falenderoi Bashkinë e Danilovgradit për bashkëpunimin dhe kontributin e jashtëzakonshëm në zgjidhjen e çështjeve të strehimit të pjesëtarëve të Armatës së Malit të Zi. Ai tha se përfundimi i ndërtesës do të jetë në fund të vitit të ardhshëm, duke thënë se në vitet e kaluara u krijua baza ligjore për fillimin e këtij projekti.



Kryetari i Danilovgradit Branislav Djuranovic tha se “po punohet për sigurimin ndërtesave të banimit” dhe se “ushtria i takon Malit të Zi, kështu që ne jemi shumë të kënaqur për të përmbushur kërkesat e Ministrisë së Mbrojtjes”. Ministri Bosković, ka përgëzuar anëtarët e Ushtrisë së Malit të Zi, me rastin e 4 prillit, ku falë përkushtimit dhe punës 12 vjeçare, bëri që Mali i Zi të jetë pjesë e aleancës më të rëndësishme në mbrojtjen ushtarake-politike në botë.

DELEGACIONI USHTARAK FRANCEZ NË PODGORICË

Kolonel Fabris Dida: Bashkëpunim intensiv në fushën e mbrojtjes

Delegacioni i Ministrisë së Mbrojtjes të Francës, të kryesuar nga nënkolonel Stefan Kareli (Stephane Carré), Shef i Departamentit për Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Turqi në Drejtorinë për Zhvillim Ndërkombëtar bëri një vizitë më 12 prill në Ministrinë e Mbrojtjes të Malit të Zi.

Delegacioni u takua edhe me Drejtorin e Përgjithshëm të Drejtorisë për Materiale, Alma Ljuljanaj, si dhe me Drejtorin për Prokurime, Stefan Šaponjic. Zonja Ljuljanaj ka falenderuar për mbështetjen e gjithanshme që Republika Franceze ka dhënë për Malin e Zi në arritjen e qëllimeve të saj euro-atlantike, me besimin se bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes ndërmjet dy vendeve, si një aleat të NATO-s, do të përmirësohen më tej në të ardhmen.

Nënkolonel Carre tha se kjo vizitë është një mundësi e shkëlqyer për përcaktimin e modaliteteve të bashkëpunimit dhe forcimin e mëte-



jshtëm në fushën e mbrojtjes.

Stefan Šaponjic, Dejan Uskokovic dhe Bojan Lucic, informuan ekipin nga Franca mbi aktivitetet më të rëndësishme të Ministrisë së Mbrojtjes të Malit të Zi të kryera në veçantë në modernizimin e Forcave të Armatosura të Malit të Zi, në përputhje me standardet dhe objektivat e aftësisë. Takimi u ndoq nga kapiteni Thierry Rubáš (Thierry Roubach), oficer tavolinë për Evropën Juglindore në Drejtorinë për Zhvillim Ndërkom-

bëtar të Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Francës dhe kolonel Fabris Dida (Fabrice Duda), atashu jo-rezident të mbrojtjes të Republikës së Francës në Mal të Zi.

Kolonel Dida foli për rezultat e dukshme që Mali i Zi ka bërë në kuadër të integritimit euro-atlantik, dhe shprehu kënaqësinë e veçantë për bashkëpunim intensiv midis dy vendeve në fushën e mbrojtjes, si dhe gatishmërinë për përmirësimin e mëtejshëm të tyre.


EKSPOZITË

Nëndetëse “Nebojska”, para 90 viteve në Tivar

Ministri i Mbrojtjes i Malit të Zi, Predrag Boskovic mori pjesë më 3 prill në ekspozitën e hapur në Muzeun Detar, nga historiani Drazhen Jovanović, përgatitur me rastin e dy përvjetorëve: 90 vjeç nëndetëse më e vjetër në Jugosllavi dhe 50 vjet që nga fillimi i përdorimit operacional të nëndetëseve “Hero”. Nëndetëset gjithmonë janë të lidhura me guximin dhe përkushtimin. “Mos harroni të gjithë ata që dhanë gjithë veten e tyre për nëndetëset”, tha ministri Boskovic në fjalën e tij.

Ekspozita është një kujtesë e nëndetëses “Nebojska” e cila hyri në gjirin e Tivarit, më 8 prill 1928. Ekspozita përfshin fotografi dhe dokumente detare në lidhje me këto dy nëndetëse: si bëhej trajnimi i personelit të nëndetëseve, ku qëndruan gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe i cili ishte fati i tyre më tej. Veterani i marinës Jan Vickers (Ian Vickers) foli se si nëndetësja “Nebojska” ka luftuar për krah me Marinën Mbretërore Britanike. Ekspozita do të jetë e hapur deri në fund të prillit.





“Bullgaria duhet të zhvillojë industrinë e prodhimit të teknologjisë së lartë dhe me vlerë të lartë, si dhe biznesin tuaj”, tha Rumen Radev. Sipas presidentit, shteti duhet të stimulojë dhe mbështesë më aktivisht punën e kompanive nga kompleksi ushtarako-industrial bullgar. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e kompanive bullgare e përcaktuan takimin si jashtëzakonisht të përpiktë dhe të frytshëm.



Presidenti Rumen Radev

Shteti duhet të ndihmojë degën ushtarako-industriale

Presidenti Rumen Radev u takua me përfaqësues të industrisë së mbrojtjes bullgare

Presidenti Rumen Radev u takua më 4 prill 2018, mbajti një takim pune të “Dondukovit” 2 me përfaqësues të kompanive bullgare aktive në sektorin e industrisë së mbrojtjes. Gjatë diskutimit u diskutuan temat lidhur me gjendjen aktuale, sfidat dhe perspektivat për industrinë bullgare të mbrojtjes.

“Bullgaria duhet të zhvillojë industrinë e prodhimit të teknologjisë së lartë dhe me vlerë të lartë, si dhe biznesin tuaj”, tha Rumen Radev. Sipas presidentit, shteti duhet të stimulojë dhe mbështesë më aktivisht punën e kompanive nga kompleksi ushtarako-industrial bullgar. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e kompanive bullgare e përcaktuan takimin si jashtëzakonisht të përpiktë dhe të frytshëm. Ata gjithashtu shkëmbyem pikëpamje mbi proceset e modernizimit në Ushtrinë Bullgare, si dhe nevojën për t’i zhvilluar ato së bashku me programet përkatëse të bashkëpunimit industrial.

U trajtuan gjithashtu çështjet lidhur me nevojën për të ndërtuar dhe trajnuar specialistë me shkathtësi dhe edukim të përshtatshëm. Çështja e sinkronizimit të legjislacionit bullgar u ngrit gjithashtu për të ofruar perspektiva për pjesëmarrje në projektet evropiane të kompanive vendase nga industria ushtarake. Në mesin e pjesëmarrësve në këtë takim ishin ministri i Ekonomisë Emil Karanikolov, përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes, Institutit të Mbrojtjes “Profesor Tsvetan L Lazarov” BAS shkencëtarët.



ME PJESË KËMBIMI
NGA RUSIA

**Avionët tanë
MiG-29 do të
riparohen në Bullgari**

Ministri i mbrojtjes Krasimir Karakaçanov shpalli se avionët gjuajtës MiG-29, me të cilët disponojnë Forcat Ajrore Bullgare, do të riparohen me pjesë këmbimi ruse në Bullgari, por jo në Rusi. Gjatë shtatë viteve të ardhshme do të fluturojnë të gjithë avionët MiG-29, të cilët janë në dispozicion dhe në të njëjtën kohë do të riparohen avionët Su-25, prej të cilëve tani fluturojnë vetëm katër. Në proces të negocimit janë projektet për blerjen e një avioni të ri gjuajtës. Deri tani është diskutuar oferta për avion të përdorur F-16, do të kërkohen oferta analogjike nga prodhuesit e avionëve F-18, “Boeing”, “Rafale”, “Eurofighter”.

KOMISIONERI EUROPIAN
STILIANIDIS

**Bullgaria: Rol kyç
për Mekanizmin
e Mbrojtjes
Civile të BE-së**

Kryeministri Bojko Borisov dhe Komisioneri evropian për ndihmën humanitare dhe menaxhimin e krizave Christos Stilianidis diskutuan në Sofje propozimin e KE-së për modernizimin e mekanizmit për operacione të shpëtimit. Pas bisedimeve Stilianidis komentoi se Bullgaria tashmë ka një rol prijës për sa i përket këtij mekanizmi në Evropë. U diskutuan dhe çështjet tjera me rëndësi gjeopolitike.

Eurokomisioneri ra dakord me mendimin e Kryeministrit se fatkeqësitë natyrore gjatë viteve të fundit kanë provuar se sistemi i deritanishëm për reagim në raste krizash në Evropë nuk u përgjigjet nevojave aktuale.

FORCA AJRORE

Stërvitje evropiane e aviacionit ushtarako-transportues

Marrin pjesë aeroplanë nga Bullgaria, Lituania, Polonia dhe Rumania, ushtarakë nga Holanda, Qendra Evropiane e Transportit Taktik Ajror dhe Komanda Evropiane e Transporti Ajror

Nga 16 deri më 28 prill në Bullgari zhvillohet etapa kryesore e kursit evropian për përsosjen e përgatitjes taktike të aviacionit ushtarako-transportues 18-2 (ETAP-C-18-2). Stërvitja është pjesë e kalendarit zyrtar të Presidencës Bullgare të Këshillit të BE-së. Marrin pjesë aeroplanë transportues, ekipazhe dhe personalë nga Bullgaria, Lituania, Polonia dhe Rumania, ushtarakë nga Holanda, Qendra Evropiane e Transportit Taktik Ajror dhe Komanda Evropiane e Transporti Ajror.

Kursi evropian për përmirësimin e përgatitjes taktike të aviacionit të transportit ushtarak po zhvillohet në aeroportet në Plovdiv dhe Bezmer, në fushën e trajnimit të Forcave Ajrore-Elena, si dhe në fushat ajrore pranë fshatrave Cheshnegirovo dhe Chernogorovo.

Gjatë stërvitjes ETAP-C 18-2, pjesëmarrësit punojnë mbi detyrat e mëposhtme të trajnimit: fluturimet e ulëta dhe jashtëzakonisht të ulëta të lartësisë; pika ajrore; simuluar pika ajrore; kapërcimi i mbrojtjes ajrore të armikut, duke përfshirë asetet e mbrojtjes ajrore bazuar në tokë dhe avionë luftarakë; ulje taktike; ulja dhe ngritja e rripit të poshtë; për avionin e avionëve të luftëtarëve - përgjimin taktik; për trupat ajrore dhe të mbrojtjes nga raketat - mbrojtja ajrore e raketave.

Qëllimet themelore të pjesëmarrjes së Forcave Ajrore Bullgare në ushtrim janë arritja e ndërveprueshmërisë më të lartë në lidhje me pjesë-

marrjen në operacionet shumëkombëshe me Aleatët, si dhe për të përmirësuar përgatitjen teorike, taktike dhe përgatitje të fluturimit në përmbushjen e detyrave të transportit. Për ekipet e fluturimit të aviacionit të avionëve luftarakë - për të përmirësuar përgatitjen taktike-speciale dhe fluturimin në përgjimin e avionëve të transportit; për trupat ajrore dhe të mbrojtjes nga raketat-për të përmirësuar përgatitjen teorike dhe taktike të posaçme në trajtimin e lartësisë së ulët, objektivave me shpejtësi të ulët; për kontrolluesit e trafikut ajror të Menaxhimit të Combat-për të drejtuar, drejtuar dhe menaxhuar lartësi të ulët, objektiva të Combat-për të drejtuar, drejtuar dhe menaxhuar lartësi të ulët, objektiva të Combat-për të drejtuar, drejtuar dhe menaxhuar lartësi të ulët, objektiva të Combat-për të drejtuar, drejtuar dhe menaxhuar lartësi të ulët, objektiva të Combat-për të drejtuar, drejtuar dhe menaxhuar lartësi të ulët.



Menaxheri ekzekutiv i ETAP-C 18-2 në anën bullgare është Kolonel Rumen Kondev, Shefi i Inspektoratit të Sigurisë së Fluturimit në Komandën e Forcave Ajrore Bullgare dhe drejtori i ushtrimit të fluturimit do të jetë koloneli Jose Luis Romero Allegue, Forca Ajrore, Spanja, e cila është komandant i Qendrës Evropiane të Taksave Ajrore.

Nga Forca Ajrore Bullgare, personeli dhe pajisjet janë nga Komanda e Forcave Ajrore, Baza e 24-të Krumovë, Baza e 3-të Ajrore Graf Ignatievo, Baza e Komandës, Kontrollit dhe Mbikëqyrjes Sofje, Baza e Pajisjeve Speciale Bozhurishte, Baza e Mbrojtjes së Raketave dhe Mbështetjes së Raketave Bozhurishte të cilët marrin pjesë në stërvitje. Fluturimet zhvillohen me aeroplanët Spartan dhe Hercules në periudhën 16-26 Prill 2018, kur do të zhvillohet ceremonia e mbylljes së stërvitjes

Në kuadrin e 60 vjetorit të krijimit të AFA-së

Thoma Xhixho, personalitet i shquar
i arsimit dhe shkencës ushtarake

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTA

Komandanti i parë i institucionit të arsimit ushtarak

Në historinë 60-vjeçare të Akademisë së Forcave të Armatosura, pa dyshim që ka një vend nderi koloneli, komandanti i parë i këtij institucioni të arsimit ushtarak Thoma Xhixho. Ai sot është një nga figurat më të shquara të arsimit e të shkencës ushtarake shqiptare të gjysmës së dytë të shek. XX.

Thoma Xhixho lindi në Sukë të Gjirokastrës në vitin 1920. Ishte pjesëmarrës në LANÇ që në fillimet e saj. Kreu detyra të ndryshme drejtuese si komandant të njësitit guerril e deri në komisar i Br. XIX S. Më 30 gusht 1944 merr gradën Major. Pas çlirimit studioi në Akademinë Ushtarake "Frunze", Moskë deri në vitin 1950. Më pas vazhdoi studimet në Akademinë e Lartë të Shtabit të Përgjithshëm "Voroshilov". Në vitin 1958 me hapjen e Akademisë Ushtarake në Tiranë emrohet komandant i saj, me gradën Kolonel.

Një nga fitoret në fushën e zhvillimit të arsimit ushtarak ishte krijimi, forcimi dhe zgjerimi i arsimit të lartë ushtarak. Në vitin 1958 vendimi i Këshillit të Ministrave theksonte formimin e Shkollës së Lartë Ushtarake në qytetin e Tiranës. Në vitin 1958 Shkolla e Naltë Ushtarake funksionoi me një program mësimor 3-vjeçar. Në vitin 1962 institucioni u emërtua Akademia Ushtarake dhe oficerët vlerësoheshin me arsim të lartë ushtarak në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 385, datë 28 tetor 1961. Akademia e Mbrojtjes u krijua si një institucion shtetëror, në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, me status të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Akademia është institucion i lartë mësimor-edukativ e shkencor që shërben për kualifikimin e kadrove të lartë të FA.

Vendimi përbënte një vlerësi për shkollën, por edhe një dukuri të re në fushën e arsimit dhe të kualifikimit të oficerëve. Ishte kjo një arritje e nxitje për rritjen e cilësisë e të veprimtarisë mësimore, pedagogjike dhe studimore e shkencore të këtij institucioni. Të gjitha këto u reflektuan në format organizative, në plan-programet mësimore, në rritjen e kërkesave profesionale ndaj metodave të mësimdhënies nga trupa pedagogjike, si dhe në zbatimin e kriterëve bashkëkohore të pranimit të akademistëve që ndiqnin studimet në akademi. Pedagogët "instrukturët" e parë ishin Ferik Hoda, Elami Hoda, Niko Dulaku, Veip Aliaj, Hysni Rusi, Dhimitër Ndrenika. Kursi i parë përbëhej nga oficerë me nivele të ndryshme arsimore. Kështu që u parashikua përgatitja e oficerit në dy nivele. Në nivelin e parë përfshiheshin lëndë të formimit të përgjithshëm, si shekncat e natyrës, ndërsa në nivelin e dytë zhvillohej programi i përbërë nga lëndët profesionale. Fillimisht, akademia kishte tri katedra: gjitharmëshe, artileri toksore e kundërrajore dhe formimi i përgjithshëm.

Kontribut të çmuar në ngritjen dhe organizimin e Akademisë

Thoma Xhixho gjatë punës në Shkolla e Naltë Ushtarake si komandant ka dhënë një kontribut të çmuar në caktimin e drejtimeve dhe organizimin e punës kërkimore shkencore në ushtri, në përcaktimin e



Komandanti i parë i arsimit ushtarak, Thoma Xhixho

tematikave, metodikave dhe formave të organizimit të punës etj.

Themelimi i Shkollës së Naltë Ushtarake ishte një ngjarje e shënuar dhe një hap shumë i madh përpara për riorganizimin, reformimin dhe zhvillimin e arsimit të lartë ushtarak dhe të kërkimit shkencor në ushtri. Me kulturën e tij të gjërë dhe aftësitë organizative, kol. Thoma Xhixho mori pjesë aktive dhe dha një kontribut çmuar për ngritjen dhe organizimin e Akademisë.

Me formimin e lartë shkencor, me përvojën e gjithanëshme të fituar në studime ushtarake dhe në punë, si edhe me intuitën e thellë për parashikime largpamëse, kol. Thoma Xhixho dha një ndihmesë të veçantë në zgjidhjen e shumë problemeve që qëndronin para institucionit të sapoformuar.

Një nga problemet e rëndësishme të fillimit, për të cilin Thoma Xhixho kishte preokupim të madh dhe bëri shumë përpjekje, ishte siguri i mjediseve të punës. Zgjedhja dhe vendosja e Shkollës së Naltë Ushtarake në vendin ku sot është ASNI, ishte varianti më i mirë dhe më i studiuar për mundësitë e asaj kohe. Më pas me vendosjen në godinën e re, ku sot është Ministria e Mbrojtjes u bë e mundur të përballoheshin në mënyrë të kënaqshme të gjitha nevojat e rritjes së vullshme të saj.

Një problem tjetër i rëndësishëm i kësaj periudhe ishte hartimi i planeve dhe i programeve mësimore. Duke u konsultuar me përvojën e shkollave perëndimore dhe të vendeve të lindjes dhe duke pasur parasysh kushtet e vendit tonë, u hartuan në mënyrë krijuese dhe origjinale planet dhe programet mësimore për përgatitjen e specialistëve të lartë ushtarakë, të përshtatshëm për të punuar dhe drejtura në njësi dhe repartee të ushtrisë.

Udhëhoqi punën për zgjedhjen e teksteve

Thoma Xhixho dhe trupi pedagogjik udhëhoqën punën për zgjedhjen e teksteve më të mira nga literatura botërore dhe për

përkthimin e përshtatjen e tyre për kushtet e shkollës së lartë ushtarake. Duke pasur parasysh natyrën e disiplinave shkencore ushtarake me karakter të theksuar praktik dhe eksperimental, një vëmendje të veçantë dhe një kohë shumë të madhe kol. Thoma i kushtoi ngritjes së bazës materiale dhe laboratorëve. Krahas udhëzimeve të hollësishme ai është marrë vetë me projektimin dhe ngritjen e laboratorëve si dhe me bërjen e porosive për pajisjen e tyre me aparataturat e nevojshme. Në këtë mënyrë, që brenda pak viteve u arrit të organizohen në mënyrë normale dhe në nivel të kënaqshëm për kohën, laboratorët e taktikës dhe të historisë ushtarake.

Një meritë të veçantë në fushën e veprimtarisë shkencore, përveç angazhimit personal, kol. Thoma pati në përcaktimin e orientimit kryesor të drejtë të punës shkencore në fushën ushtarake dhe të shkencës së artit ushtarak, që në mënyrë të përmbledhur ishte njohja, studimi dhe vlerësimi i burimeve njerëzore për kontributin e tyre në forcimin dhe mbrojtjen e atdheut, zgjedhja e caktimi i rrugëve më të përshtatshme për konkretizimin e njohurive në terrenin konkret dhe të stërvitjeve ushtarake. Ky orientim kryesor bëri të mundur që nga ana e pedagogëve mësimorë-shkencorë të katedrave, në veçanti, dhe të katedrave të tjera të Shkollës së Bashkuar, në përgjithësi, të ndërmerrej një numër i madh temash ushtarake për tu përgatitur nga kursantët. Për kryerjen e këtyre studimeve u aktivizuan me pedagogë mësimore dhe shkencorë dhe kursantë. Rezultatet e këtyre studimeve ishin konkretizuar në formën e dhjetëra monografive e të një numëri të madh artikujsh shkencorë, të punimeve të diplomave etj. Përveç kësaj, rezultatet e punës kërkimore shkencore në Akademi u kanë dhënë një ndihmë të dukshme edhe njësitëve dhe reparteeve të ushtrisë. Nga ana tjetër, aktivizimi në punë shkencore i punonjësve mësimore bëri të mundur kualifikimin shkencor të tyre dhe ngriti nivelin shkencor të procesit mësimor. Kol. Thoma Xhixho vazhdimisht theksonte se katedrat e



Godina e pare, viti 1958

Akademisë duhet të qëndrojnë në pararojë të mendimit shkencor në ushtri duke e harmonizuar atë me procesin mësimor.

Bërthama e qendra shkencore pranë katedrave

Në procesin e rritjes dhe të zhvillimit të veprimtarive shkencore u krijuan forma organizative të përshtatshme, si grupe pune, bërthama e qendra shkencore pranë katedrave, disa prej të cilave me zhvillimin e mëtejshëm të ushtrisë ndikuan në krijimin e insituteve e të njësitëve të veçanta shkencore ushtarake.

Në vitin 1961 Akademia kishte edhe student ushtarak që u kthyen nga shkollat e larta të vendeve të Lindjes, si pasojë e prishjes së marrëdhënieve politike me këto vende. Nën drejtimin e kol. Thoma Xhixhos, për secilin nga këta studentë u hartua një program individual me synimin që, sa të ishte e mundur, t'u ruhej profili i degës ushtarake që kishin nisur në shkollat nga vinin. Mund të pohohet se brenda pak vitesh kjo detyrë u realizua me sukses.

Me zhvillimin dhe konsolidimin e katedrave ushtarake, me forcimin relativ të bazës materiale laboratorike, me fitimin e përvojës dhe ngritjen e kualifikimit shkencor të kuadrit ushtarak, nën udhëheqjen e Kol. Thoma Xhixhos, u krijuan dhe degë të reja në Akademi. Në vitin 1965 emrohet drejtor i Përgatitjes Luftarake të Ushtrisë dhe merr gradën gjeneralmajor.

Nga viti 1974 në programet e akademisë u përfshinë temat e nivelit të brigadës dhe të korpusit, që synonte të përmbushte një objektivi për të përgatitur oficerë të aftë, të nivelit taktiko-operativ. Programi ndërthurej me stërvitje komando-shtabi, dalje në terren, si dhe pjesëmarrje në stërvitje me trupa që organizoheshin në vitet '70-'80 në Ushtrinë Shqiptare. Në vitet '80 akademia ndërmoi ndryshime të reja cilësore në pikëpamje të organizimit dhe të përmbajtjes së programeve mësimore e studimore-shkencore. Kjo u pasqyrua ndjeshëm në procesin e mësimdhënies dhe në formimin profesional të akademistëve. Në akademi u përfshinë dhe oficerë të FLD, të Aviacionit dhe nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Akademia Ushtarake ishte njëherësh dhe një institucion studimor-shkencor,

misioni i dhënë nga ministri i Mbrojtjes në Urdhërin Nr. 00303, datë 1 gusht 1973 ku thuhet të organizohet puna ushtarake-shkencore dhe të krijohet në akademi një bërthamë shkencore. Kështu në këtë periudhë u krijua sektori i studimeve shkencore ushtarake. Një pjesë e këtyre studimeve janë botuar dhe publikuar në vend. Shumë punonjës shkencor e pedagog u përfshinë në kualifikimin shkencor pasuniversitar me mbrojtje të disertacioneve duke fituar grada shkencore. Nga mesi i vitit 1976 institucionit ju dha e drejta e kualifikimit pasuniversitar dhe mbrojtja e gradave shkencore në fushën e mbrojtjes.


Gjatë viteve '70-'90 në akademi u zhvilluan veprimtari mësimore-pedagogjike dhe studimore-shkencore që lidheshin me përgatitjen e programeve të reja mësimore, metodika, rregullore luftimi, tekste mësimore, bazë materiale-didaktike. Janë organizuar sesione, konferenca e simpoziume shkencore dhe është realizuar një numër botimesh cilësorë dokumentare për historinë ushtarake dhe artin ushtarak të periudhave të ndryshme. Vend të rëndësishëm zënë numëri i konsiderueshëm titujsh, artikujsh shkencorë e studime të shumta. Deri në vitet '70 akademia kishte emblemën dhe stemën e vet duke j'u dhënë oficerëve që përfundonin studimin në këtë institucion.

Sukseset e arritura në fushën e arsimit ushtarak, të kulturës dhe të shkencës, përvoja e grumbulluar nga shkollat ushtarake, si dhe detyrat e reja që qëndronin para mbrojtjes së vendit, për një zhvillim të gjithanshëm të tyre, për një ngritje të mëtejshme të punës për përgatitjen e kadrove të lartë të ushtrisë bënë të nevojshëm dhe të mundshëm krijimin e Akademisë së Mbrojtjes në Tiranë. Akademia e Mbrojtjes përgatit kadro të lartë të pajisur me dije të nevojshme bashkëkohore për të kryer detyrën si ushtarakë të lartë të FA. Mbi këtë bazë është ndërtuar e gjithë puna në Akademinë e Mbrojtjes, duke përfshirë parimet themelore të organizimit, të veprimtarisë mësimore shkencore, të brendisë dhe të metodave të tij. Gjenerali Thoma Xhixho në vitin 1978 del në pension dhe ndërron jetë në vitin 2002, duke mbetur një emër i ndritur në historinë e arsimit të lartë dhe të shkencës ushtarake.

ALBERT Z. ZHOLI

Si na ndalonin të takonim ushtarakët e NATO-s në Paris

Flet, Hasan Luçi, ish-Atashe konsullor, shtypi dhe kulture në Paris



Ai shkoi në Paris, kur u shpall prishja e PPSH-së me ish-kampin socialist, pas raportit të Enver Hoxhës në Kongresin e IV-t, nëntor 1961 deri në vitin 1968. Në vitet 1968-1971 u kthye në Shqipëri me detyra të ndryshme dhe në nëntor 1971 shkoi sërish në Ambasadën tonë në Paris si sekretar i parë. Ka shumë kujtime me atashetë e huaj ushtarake të asaj kohe që ishin në Paris, sepse Shqipëria nuk kishte atashe ushtarake, për shkak të izolimit dhe ndarjeve ideologjike. Por ai ka kujtime edhe me ushtarakë francezë.

Si i realizonit dhe cila ishte puna juaj me atashetë ushtarake në Paris, duke ditur që i kishit të kufizuara takimet dhe lëvizjet?

Me atashetë ushtarake të akredituar në Francë ne takoheshim në pritjet diplomatike. Në tërësi këta ishin aktivë, pasi kishin edhe punë të vështirë, por edhe me objekt më të përcaktuar, se sa shtypi e kultura, pra edhe më të përqendruar në punën e tyre. Në radhë të parë takoja, me raste, po në pritje në ambasadën e tyre ose të tjera, atasheun ushtarak kinez dhe zëvendësin e tij. Me ta shkëmbeu vlerësime për çështjet ushtarake, sidomos në kohën e krizave më të mëdha. Herë herë thoshin se ne kishim mundësi më të mira për të njohur gjendjen në Europë, se ne ishim edhe më të interesuar. Megjithatë kinezët mblidhnin çdo gjë të botuar në çdo fushë dhe i çonin në Kinë për t'i studiuar atje me qetësi, pasi e kishin mundësinë studiuese dhe ekonomike për specialistët e tyre.

Sa atashe ushtarake njoho në atë periudhë?

Unë njoha shumë atashe ushtarake të vendeve të ndryshme, si nga Siria, Egjipti, Tunizia, Belgjika, Islanda, Turqia, Greqia, Italia, Venezuela, Jugosllavia, Rumania, Hungaria, Polonia, Bullgaria, Islanda. Ne diplomatët e kishim të ndaluar të bisedonim me diplomatët amerikanë, sovjetikë, izraelitë, anglezë etj., me të cilët s'kishim marrëdhënie diplomatike për faj të politikës së vendeve të tyre ndaj vendit tonë, për shkak të rrethanave të kohës. Por kishte raste që zihesha ngushtë, pasi ata nuk e kishin të shkruar në ballë se nga ç'vend ishin. Kështu u ndodha përballë me një izraelit, i cili zgjati dorën, pa e ditur edhe ai se kujt i drejtohej por, ndërkohë, na njohu një profesor francez. Unë i thashë se, si diplomat s'duhej ta takoja, por besoj e dinte se gjatë pushtimit fashist gjerman ne i mbrojtëm çifutët në Shqipëri. Ai tha se e dinte, por me kaq u ndamë. Urdhri për të mos u takuar me diplomatët të disa vendeve që ekstrem, pasi në fakt, diplomatët edhe në rast lufte kërkojnë rrugë për t'i vendosur lidhjet diplomatike, që janë krijuar për këto qëllime dhe afrojnë popujt mes tyre. Këtë hap e bënë të parët grekët në Paris me urdhër të kolonelëve, dukej se kishin direktivën se na drejtoheshin direkt. Kjo u pa pas incidentit të piratit të ajrit Vasil Cironi, që u ul në Vlorë, ku pasagjerët u trajtuan mirë, panë qytetin dhe folën mirë për gjendjen atje. Lirimi i pasagjerëve u prit mirë nga grekët si vullnet i mirë i qeverisë sonë.

Ju sigurisht ishit të angazhuar shumë me shtypin po me shtypin ushtarak francez çfarë lidhje kishit?

Megjithatë nuk jam specialist i mirëfilltë i çështjeve ushtarake, bëra përpjekje të krijoja lidhje miqësore me shtypin ushtarak francez, sidomos për çështje informacioni, pasi ne nuk kishim atashe ushtarake në Francë si vendet e tjera, ky një qëndrim i veçantë yni. Krijova miqësi edhe me atashe ushtarake të vendeve të tjera atje. Por më e lehta ishte njohja e miqësia me ushtarakë francezë në pension, të cilët shkruanin në shtypin e specializuar e gjatë. Kështu, veç gjeneral Tyberit në selinë tonë, u njoha në pritjet diplomatike me gjeneralin Gambiez, të cilit i kisha lexuar edhe veprën e tij dhe artikuj të ndryshëm në revista, ku shquhej si analist i çështjeve ushtarake. Ishte tip simpatik, më prit në zyrën e vet dhe bisedat

me të qenë interesante, sidomos vlerësimet e tij për ballafaqimin mes dy blloqeve në Luftën e Ftohtë, mbi krizat në Lindjen e Mesme, mbi krizën e Kubës, mbi gjendjen në Mesdhe e në Ballkan etj. Kurse gjeneral Pier Solanin e njoha në pritjet diplomatike dhe, gjatë bisedave me të, kuptova se ai kishte një këndvështrim real të gjendjes në Evropë për vlerësimin e aleancave ushtarake. Kishte prije të forta atdhetare. Ndërsa Zhak Isnari ishte specialist për çështjet ushtarake në gazetën "Lè Mond". Ishte i saktë e korrekt në trajtimin e çështjeve me interes që bisedonim me njeri tjetrin. Arritëm e krijuam marrëdhënie miqësore. Qe i ri, si unë, dhe gazetar interesant. Analizat e lajmet e tij qenë me vlerë. Njoha edhe Samuel Pissar, po i këtij profili në këtë gazetë, por ky ishte pacifist dhe mbante rezervë në vlerësimet që bënte.

Cila ishte puna juaj me shtypin krahinor francez?

Shtypi krahinor francez ishte më i madh, në tirazh, se ai parisian, prandaj edhe përpjekjet e mia për marrëdhënie të mira me të kishin rëndësi. Por me këtë shtyp ishte më vështirë të punoje për vet problematikën që trajtonin, duke mos e vënë theksin mbi çështjet e jashtme, por ato të brendshme të vendit të tyre. Unë u bëra vizita disa kryeredaktorëve të gazetave të krahinave dhe u dorëzova materiale mbi vendin tonë, veç atyre dërguar me postë, i ftoja në pritjet tona të ndryshme. Klod Burzhua, drejtor i redaksisë parisiane të gazetës "Dofinë libere", ishte një njohës i mirë i çështjeve politike dhe të shtypit, një bashkëbisedues i këndshëm. Pasi u njoha dhe i çova materialet tona, nuk vonoi të shkruante me objektivitet dhe dashamirësi. Ai e theu i pari akullin e shtypit krahinor për Shqipërinë. Së bashku me miq të tjerë të shtypit krahinor e ftova edhe për darkë në seli, ku u njohën edhe me kuzhinën shqiptare dhe na uruan që i mblodha për t'u parë edhe mes tyre. Kjo gazetë kapte rajonin e dytë të Parisit, ku banonin shqiptarë nga të dy anët e kufirit tonë shtetëror. Zhan Mënie, president i "La Nuvel Republik" i qendrës perëndimore, i departamentit të Luar të Orleanit, jo vetëm që shkroi vetë

teresova të mësoja mekanizmin e agjencive të shtypit, së pari, të AFP-së (Agjencisë Frans Pres), e njohur në tërë botën dhe me autoritet. Atje u takova me shefin e sektorit diplomatik, Mishel Lëlë, i cili qe një babaxhan, diplomat me përvojë, i moshuar, i sjellshëm e mikpritës, megjithatë kishim diferencë të madhe në moshë. U miqësua m shpejt. Ai më ftoi disa herë dhe vizitova zyrtar e kompjuterët e AFP-së në punë. Më tregoi edhe kompjuterin, i cili nxirrte automatikisht lajmet e ATSH-së sonë, që futeshin në buletin e brendshëm, edhe çështje të ndryshme për lajmet e gazetave. AFP-ja e bënte punën e saj për t'i marrë lajmet nga Shqipëria, por politika ishte kudo në plan të parë gjatë "Luftës së Ftohtë", jo vetëm të PPSH-ja. Ai më njohu edhe me gazetarë të tjerë të saj.

Një nga gazetarët e agjencisë Skop (SCOP), Zhak Gijar, pasi kishte pëlqyer artikujt e Zhan Bertolinos mbi vendin tonë, kërkoi materiale për t'i botuar më vitin 1974. Ai botoi gjëra të shkurtra për ekspozitën e artit shqiptar në shekuj, për filmat shqiptarë etj. Gjatë qëndrimit në Paris, si atashe shtypi, mbahta lidhje me agjencitë e huaja të lajmeve në Paris dhe, u dërgoja, rregullisht, materialet tona, sidomos, buletin e ATSH-së etj.

Cilat kanë qenë takimet tuaja me ushtarakë të lartë francezë?

Nëpër pritjet e ndryshme në Paris merrnin pjesë edhe ushtarakë, sidomos ish-gjeneralë në pension e të tjerë në

shërbim. Nga këta u njoha dhe pata takime në zyrën e tij ose në pritje me gjeneralin Gambiez, që punonte në revistën "Mbrotjtja franceze". Ishte tip mjaft interesant, i hapur, i zgjuar dhe i aftë për çështjet ushtarake. Artikujt e tij qenë të thellë e seriozë. Prej tij kishe çfarë të mësoje edhe mes rreshtave, siç thuhet zakonisht nga diplomatët e gazetarët. Po kështu gjenerali Charl Bryn i revistës "Ushtria e re". Prej tyre merrej informacion ushtarako-politik me interes. Lidhje të gjata miqësia



e "La depeh dy Midi" dhe Zhyll Klover të gazetës "Nor Ekler" që m'i njohu miku im gazetar Zhan Bertolino. Gjithashtu njoha Bernar Volfin, drejtor i redaksisë dhe drejtor politik i gazetës "Paris-Normandi", që u bë miku im dhe dha ndihmesën e tij me shkrime.

Ku konsistonte puna me agjencitë e shtypit francez?

Gjatë qëndrimit në Francë në vitet '70, për nevojat e sektorit të shtypit, u in-

pata me kolonel Hyber Kurnal, me origjinë nga Madagaskari, që punonte në shërbimet e prapavijës. Tip simpatik, i hapur dhe i shoqërueshëm, mbante lidhje me shumë njerëz, qe bërë i njohur dhe nuk mungonte në pritjet diplomatike, gati kudo. Me Stilianin qeshnim se nuk e hoqi zakonin e ushtarakut: të merrte qëndrim gatitu kur takonte miqtë në pritje apo në seli, pasi i qe bërë shprehi nga jeta e gjatë ushtarake, megjithatë në Paris qe diplomat e jo atashe ushtarak i mirëfilltë.

Takime me personalitete të partive franceze?

Në një pritje u njoha me senatorin Ribie, i partisë "e majta demokratike", shkëmbeu përshtypje e mendime sa herë takoheshim. Po kështu njoha edhe Dominik Tadein, sekretar kombëtar dhe i deleguar për veprim kulturor i PS-së së Francës. Gjithashtu Lionel Jospin, anëtar i sekretariatit të PS-së i ngarkuar për marrëdhëniet me vendet e botës së tretë, por tregojë i kursyer në biseda. Në fund të shekullit të kaluar u bë kryeministër i Francës.

Njoha edhe Charl Herny, ish-deputet, anëtar i komitetit drejtues të PSF-së dhe kryetar i konventës së kuadrove në rezervë për një ushtri të re. Ka shkruar disa libra dhe mua më dhuroi atë "Ushtri qytetar", ese për mbrojtjen dhe sigurinë e Francës. Qe shkrimtar i njohur. Ishte njeri i sjellshëm dhe kishte interes të bisedonte për Shqipërinë, pasi i tërhoqin vëmendjen çështje të ndryshme. Me të shkëmbeja mendime politiko-ushtarake dhe nuk mungonte të paraqiste pikëpamjet e veta ose qëndrime të qeverive të ndryshme. Qe i saktë e i kuptueshëm. U takova me të në vitet '60-'70. Ky u bë ministër i mbrojtjes.

Takime nëpër pritje dhe, herë pas here, të planifikuara pata edhe me Mishel Rokar, ish drejtues në PSF, i majtë, një parti e vogël, por luante rol në lojrat zgjedhore. Ky ish mik i vjetër i Shqipërisë. Gazeta e tyre botonte edhe lajme mbi vendin tonë. Ishte njeri i thjeshtë dhe i shoqërueshëm, sillej me vëmendje ndaj bashkëbiseduesve, i saktë në vlerësimet e veta, njihje mirë politikën europiane dhe atë të Lindjes së Afërt e të Mesme. Vijova takimet në vitet '60-'70, vinte në pritjet dhe në veprimtaritë tona kulturore dhe të shoqatës franko-shqiptare. Në vitet '90 u bë kryeministër i Francës.

Në vitet '60-'70 pata takime me inxh. Leon Lavale dhe me gruan e tij Limuzina. Ishin një çift simpatik nga Bordoja, të dy anëtarë të PKF-së, por miq të vjetër të Shqipërisë, të shoqatës së parë të miqësisë Francë-Shqipëri. Lavale ishte ekonomist, redaktor i revistës së PKF-së, njohës i mirë i problemeve ekonomike botërore. Edhe pas prishjes së marrëdhënies me PPSH-së e PKF-së, ky çift vijoi miqësinë dhe lidhjet normale me ne, vinin në pritjet dhe veprimtaritë tona e të shoqatës së re. Ka shkruar mbi çështje ekonomike të vendit tonë. Ishte nga miqtë më besnik të Shqipërisë.

Shkrimtari Zhak Deby-Bridel, veterani antifashist, më dhuroi librin e vet më 27 nëntor 1974, me këtë përkushtim: "Z. Hasan Luçi, këtë dëshmi "De Goli konstator" në 30 vjet lufte për pavarësi e liri, me tërë simpatinë time për Shqipërinë, vend i lirë. Shumë miqësisht" Zh. Deby-Bridel. Ky ka shkruar shumë vepra historike mbi ngjarje të Francës, shumë romane dhe ese etj. qysh nga vitet '30 të shek. të XX. Gjykimet e tij politike qenë të sakta dhe pa zburime. Nuk mera-kosej për hendekun mes moshave tona.

“Të mbajmë pastër tokën që duam”

Efektivët e Forcës Tokësore, i janë bashkuar aksionit kombëtar “Të mbajmë pastër tokën që duam”. Që në orët e para të mëngjesit të datës 16 prill, rreth 220 trupa dhe 15 mjete, kanë filluar pastrimin e territorit të vendit në pikat më nevalgjike të tij. Operacioni zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me pushtetin vendor të prefekturave Tiranë, Shkodër, Berat. Ndërkohë bazuar në planin e veprimit për pastrimin e përrrenjve dhe lumenjve në datat 16-22 prill 2018, strukturat e Forcës Detare me efektiv prej 30 vetash dhe dy mjete, filluan operacionin e pastrimit në segmentin ura e Gjolës të Bashkisë Fushë-Krujë. Kurse rreth 140 forca dhe 8 mjete transporti 5 mjete vetëshkarkuese 1 fardromë, si dhe 1 ekskavator të Komandës Mbështetëse po zhvillojnë aksionin 1 javë i cili do të finalizohet në datën 22 prill 2018, datë e cila shënon Ditën Ndërkombëtare të Tokës. Harta e shtrirjes së këtij aksioni fillon me Prefekturën e Tiranës, Elbasanit, Dibrës, Kuksit, Gjirokastrës dhe përfundon më prefekturën e Korçës, ku vëmendja kryesore është përqendruar me tepër në pastrimin e objekteve me vlera kulturore dhe turistike siç është ura e Brarit në Tiranë, plazhi i Rallnikut në njësinë administrative Pustec-Pogradec, si dhe pastrimi i tre segmenteve të lumit Valbona në Bashkinë Tropojë.

